

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7846 E martë 9 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**I**dashur Elez, e kam lexuar jo pa lëqardhje, fjalën Tuaj në ceremoninë e përvjetorit të 110-të të gazetës "Dielli". Konsiderata personale për Ju, e lidhur me ...  
Vijon në faqen 20

Nga EDI RAMA

Një përgjigje për Elez Biberajn



Opinion **i** Ditës

"Shfaqja" e kryeministrit në Kukës s'është ilustrimi vajtues, se sa larg mund të shkojë një individ, vetëm për karrigen e pushtetit. Që të shkosh në Kukës e të marrësh ...  
Vijon në faqen 21

Nga BARDH SPAHIA

Misioni i 13 prillit



Zgjedhjet, 16 parti dorëzojnë dokumentet

## PS-ja regjistrohët në KQZ për 30 qershorin. Basha: Ejani në Tiranë të rrëzojmë Edi Ramën

Kriza politike, Meta: I pakënaqur, shpresoj për një kthesë, duhet dialog dhe konsensus

Nga VALENTINA MADANI

Opozita ka intensifikuar përpjekjet për një pjesëmarrje sa më të lartë në protestën e 13 prillit kundër qeverisë "Rama". strukturat angazhim maksimal që protesta e 13 prillit të jetë më masivja. Kërkesa vijon të mbetet e pandryshueshme ...  
Në faqen 4-5

## HASAN HOXHA: REFORMA, SUGJERIME KONKRETE PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

# EKSPERTI: SI FUNKSIONON SKEMA E RE E PENSIONEVE

Ish-zv.drejtori i Institutit të Sigurimeve: Pensionistët e pakënaqur nga masa e përfitimit, zgjidhja brenda ISSH. Problem jo ligji në vetvete, por zbatimi i tij



(Në foto) Pensionistë

Në faqen 10-11

TRAFIKU I DROGËS

**Prokuroria kërkon 18 vite burg për Klemend Balilin, vendimi më 23 prill**

Në faqen 7

REKTORI I UT

**Takimi me studentët, Rama sulmon Mynyr Konin: Universiteti s'është për tendera**

Në faqen 13

SHKELQIM GANAJ

**Kreu i ILDKP-së: Mbi 20 deputetë dyshohet se kanë fshehur pasurinë**

Në faqen 5

SHOWBIZZ

**Zbulohet lidhja e vajzës së ish-deputetes së PD-së me Erik Fullanin**

Në faqen 15

ZYRTARI I LARTE I SHBA



**Matthew Palmer në Tiranë, 100 minuta me Ramën, sot takon Bashën dhe Kryemadhin**

Në faqen 3

Arrestohen 4 të dyshuar, akuzohen për trafik kokaine drejt Gjermanisë

## Pranga grupit të drogës, do bënin atentat

Pranga Leonard Dukës dhe Elvis Gaçajt, sekuestrohet makina e blinduar

**TIRANË**-Një grup i strukturuar kriminal, i përfshirë në trafikun ndërkom-bëtar të drogës është goditur dje nga policia e Tiranës. Mësohet se grupi me bazë në kryeqytet trafikonte kokainë në drejtim të Gjermanisë, ndërsa merrej edhe me shpërndarjen e lëndëve



narkotike. Gjatë superakcionit të policisë kanë përfunduar në pranga katër persona, përfshirë kreun e grupit, Leonard Duka; pjesë-tari Elvis Gaçaj, ndaj të cilit është kryer atentat në vitin 2015, si dhe Oltion Logaj dhe Dritan Agaj ...  
Në faqen 6

# KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Situata politike, presidenti takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së

## Kriza, Meta: I pakënaqur, shpresoj për një kthesë 180-gradëshe

"Dialog dhe konsensus i përparuar për reformat"

Valentina Madani

Presidenti Ilir meta apeloi sërish palët politike në vend për konsensus, me qëllim zgjidhjen e krizës aktuale. Në kushtet kur vendi pret një përgjigje për hapjen ose jo të negociatave dhe ku do të marrim presidencën e radhës të OSBE-së, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, shprehu dje pakënaqësinë për gjendjen aktuale politike, duke nënvizuar se shpreson të ketë një kthesë 180 gradë sa më parë. Nga Byroja e Asamblesë së BE-së ku ishte i ftuar ndëri, kreu i shtetit theksoi se situata duhet të ndryshojë së më parë për hir të rolit që Shqipëria duhet të luajë në rajon dhe më gjerë. "Do të kisha dashur një gjendje më optimiste politike të vendit tonë, të paraprirë nga një dialog politik i mirëstrukturuar dhe konsensus i përparuar mbi 5 fushat kryesore të reformave. S'e fshih dot faktin që nuk jam i kënaqur me situatën aktuale, për të cilën shpresoj të marrë një kthesë 180-gradëshe të arsyeshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe më mirë herët se sa më vonë, duke pasur parasysh gjithashtu rolin shumë të rëndësishëm që Shqipëria duhet të luajë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si një faktor vendimtar për të forcur stabilitetin dhe sigurinë rajonale", deklaroi z.Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dje në Byronë e Asamblesë së BE-së

### THIRRJA

"Së afërimi, Shqipëria pret Raportin e Përparimit të Komisionit Europian dhe vendimin pasues të Këshillit Europian, lidhur me mundësinë e hapjes së negociatave për anëtarësim. Do të kisha dashur një gjendje më optimiste politike të vendit tonë, të paraprirë nga një dialog politik i mirëstrukturuar dhe konsensus i përparuar mbi 5 fushat kryesore të reformave", tha z.Meta.

Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën, Matthew Palmer

### DEKLARATA

"S'e fshih dot faktin që nuk jam i kënaqur me situatën aktuale, për të cilën shpresoj të marrë një kthesë 180-gradëshe të arsyeshme sa më shpejt të jetë e mundur dhe më mirë herët, se sa vonë, duke pasur parasysh gjithashtu rolin shumë të rëndësishëm që Shqipëria duhet të luajë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si një faktor vendimtar për të forcur stabilitetin dhe sigurinë rajonale", deklaroi z.Meta.

## Regjistrimi, 'Vetëvendosje' drejt zyrtarizimit si parti politike në Shqipëri

Lëvizja 'Vetëvendosje' duket se ka hedhur një tjetër hap drejt prezencës së saj në Shqipëri, ndërsa përfaqësues të kësaj force politike kanë bërë kërkesë për hapjen e një organizate jofitimprurëse. Elvis Hoxha, në një postim në rrjetin social "Facebook", lajmëroi se kryetari i Bordit për mes një vendimi unanimit është përcaktuar Enis Sulstarova, për të vijuar me anëtarët: Liburn Aliu, Hysamedin Feraj, Elvis Hoxha, Dejana Mihali, Sami Kurteshi, Arbër Zaimi dhe Gearda Demiraj. Ndërkaq, drejtor ekzekutiv do të jetë Boiken Abazi. Mundësia e përfshirjes së Lëvizjes 'Vetëvendosje' në skenën politike shqiptare është lakuar shpeshherë si mundësi edhe nga lideri i kësaj



force politike. Këta të fundit nuk e kanë mohuar mundësinë e gjetjes së terrenit, duke e arsyetuar këtë alternativë me rënien e besimit tek partitë tradicionale. Ndërkaq, kërkesa për t'u regjistruar si OJF përbën hapin e parë ligjor drejt një nisme të tillë. Një nga zërat më pro 'Vetëvendosjes', autori dhe veprimtari i njohur, Hysamedin Feraj ka shkruar në "Face-



### KËRKESA

Një nga zërat më pro 'Vetëvendosjes', autori dhe veprimtari i njohur, Hysamedin Feraj, shkruan në "Facebook" se Lëvizja 'Vetëvendosje' ka bërë kërkesë zyrtare në Gjykatën e Tiranës për t'u regjistruar si parti politike.

book" se Lëvizja 'Vetëvendosje' ka bërë kërkesë zyrtare në Gjykatën e Tiranës për t'u regjistruar si parti politike. Feraj jep edhe emrat e anëtarëve të bordit të organizatës, jep qëllimet, kurse shprehet se presin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendimin në lidhje me regjistrimin e kësaj qendre brenda afatëve ligjore.

në Shqipëri dhe se si mund të ndihmojë OSBE-ja. Gjithashtu, diskutuam kryesimin e ardhshëm të OSBE-së nga Shqipëria, në mënyrë që të jetë e suksesshme", shkruan Greninger.



## Vasili: Reforma në drejtësi po sakrifikohet për të mbrojtur Ramën

Ish-deputeti i LSI, Petrit Vasili, shprehu dje shqetësimin se reforma në drejtësi ka hyrë në rrugë të gabuar. Vasili citoi raportin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, ku sipas tij mbi 60% e shqiptarëve nuk besojnë në reforma në drejtësi. Sipas tij, po sakrifikohet reforma në drejtësi për të mbrojtur Edi Ramën. "Kam thirrje për të gjithë ata entuziastë që këmbëngulin për të folur për një sukses dhe ecuri shumë pozitive dhe shpresëdhënëse të reformës në drejtësi. Nuk mund të fshihemi pas gishtit. Reforma në drejtësi ka hyrë në rrugë të gabuar. Shkaku është kapja e drejtësisë nga Edi Rama. Të sakrifikosh reformën në drejtësi vetëm e vetëm për të mbajtur Edi Ramën, i cili e do këtë reformë për t'u mbrojtur nga pandëshkueshmëria e këtij korrupsioni të frikshëm që godet tek 'Unaza e Re', që po godet tek Bregu i Lumit qytetarët e tjerë, korrupsioni që nuk ndëshkohet", tha z.Vasili. Ai shtoi më tej: "Ata që vjedhin e plaçkitin buzëqeshin e shëtisin, ndërsa qytetarët që duan të mbrojnë shtëpinë e tyre burgosen. Kjo është drejtësia që shumica e shqiptarëve nuk e besojnë më. Mbi 60% e tyre nuk e besojnë më reformën në drejtësi dhe refuzojnë të gjitha sugjerimet ngado që vijnë në shqip e në anglisht, duke e shtuar në një sukses të pagënë që e ka lënë vendin pa drejtësi, gjykata por ka garantuar edhe pandëshkueshmërinë absolute për qeveritarët që janë bërë njësh me krimin dhe bëjnë korrupsion në mes të ditës. Në mënyrë që shqiptarët të kthehen në shtëpi duhet çuar para drejtësisë këta që po shkatërojnë drejtësinë duke filluar nga Edi Rama".





Kryeministri priti dje për rreth 100 minuta zyrtarin e lartë amerikan, Matthew Palmer

# Zgjidhja e krizës, Rama: Dakordësi e plotë me amerikanët

"Një bashkëbisedim i frytshëm me zv.ndihmës Sekretarin e Shtetit"

Kryeministri Edi Rama e cilësoi një bashkëbisedim të frytshëm që solli një dakordësi të plotë lidhur me atë që mendojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe qeveria lidhur me krizën politike që ka mbërthyer vendin tonë prej gati dy muajsh. Ai priti dje në një takim të veçantë zëvendësndihmës Sekretarin e Shtetit për Evropën Matthew Palmer me të cilin bisedoi mbi një sërë çështjesh të nxehta dhe me interes për Shqipërinë dhe rajonin, përfshi procesin e integritimit, marrëdhëniet dy palëshe, dialogun Kosovë-Serbi dhe padyshim edhe krizën politike në vend. Takimi zgjati për rreth 100 minuta dhe kryeministri Rama shoqërohej në këtë takim nga ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali, ndërsa zyrtari i lartë amerikan nga përfaqësues të ambasadës së SHBA në Tiranë. Disa nga detajet e këtij takimi i ka zbardhur vetë kryeministri Edi Rama nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, ku vë në dukje arrijtjen e dakordësisë së plotë të mendimeve që kanë palët mbi çështjet e diskutuara, përfshi këtu edhe krizën politike në vend në vend dhe daljen prej saj. "Marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale, integrimi evropian i Shqipërisë, dialogu Kosovë-Serbi dhe situata politike në vend, në një bashkëbisedim të frytshëm që na gjeti në dakordësi të plotë me zv/ndihmës Sekretarin e Shtetit, Matthew Palmer", shkroi Rama duke e renditur çështjen e zhvillimeve të brendshme politike, në fund të listës së temave të diskutuara më zyrtarin amerikan.



Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën, Matthew Palmer, me kryeministrin Edi Rama

**RAMA**  
"Marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale, integrimi evropian i Shqipërisë, dialogu Kosovë-Serbi dhe situata politike në vend, në një bashkëbisedim të frytshëm që na gjeti në dakordësi të plotë me zv.ndihmës Sekretarin e Shtetit, Matthew Palmer", shkroi Rama duke e renditur çështjen e zhvillimeve të brendshme politike, në fund të listës së temave të diskutuara më zyrtarin amerikan.

## Soreca: Ura e kompromisit ekziston, por ajo duhet gjetur nga partitë

Bashkimi Europian vijon të këmbëngulë në nisjen sa më parë të dialogut politik mes mazhorancës dhe opozitës për të kapërcyer krizën e rëndë politike që ka mbërthyer vendin prej gati dy muajsh. Ambasadori i Bashkimit Europian, Luigi Soreca është i bindur se vetëm përmes vullnetit politik palët mund të gjejnë kompromisin edhe atëherë kur duket se mundësia për rrugëdalje është e pamundur. Sipas tij ura e kompromisit ekziston, por ajo duhet gjetur nga ana e palëve politike në Shqipëri. "Ne kemi qenë të parët që prej shkurtit 2016 që kemi bërë thirrje për dialog dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë gjë në çdo moment, në çdo takim. Tani ka ardhur koha për kompromis. Kompromisi do të thotë që qeveria dhe opozita të takohen në mesin e rrugës. Ura ekziston dhe ajo thjesht duhet gjendur" - u shpreh Soreca. Ndërkohë që duke folur për ecurinë e reformës në drejtësi, ai theksoi se deri më tani rezultatet kanë qenë të kënaqshme, ndërsa nxiti organet e vetingut që të vazhdojnë më tej punën e tyre. Sipas tij duhet të ekzistojë një balancë e pranueshme mes shpejtësisë së vetingut dhe cilësisë në vendimmarrje. "Po jam i kënaqur me shpejtësinë dhe mënyrën si po ecën pasi unë besoj se procesi i vetingut duhet të jetë një ndërthurje nga njëra anë shpejtësia dhe nga ana tjetër cilësia. Mos të harrojmë që këtu bëhet fjalë për të drejtat e njeriut dhe magistratëve që po e kalojnë këtë proces dhe kjo është e rëndësishme. 120 vendime janë marrë tashmë po ashtu presim dhe vendime të tjera në të ardhmen dhe ne presim që të ketë një drejtësi të mirë ndërmjet shpejtësisë dhe cilësisë" - theksoi Soreca. Ambasadori i BE-së nuk pranoi të komentojë gjatë lidhur me zgjedhjen e kryeprokurorit të ri duke vlerësuar se është shumë shpejt për të folur për një proces që sapo ka nisur.



Nga ana e Shoqërisë "Shërbimi Përmbarimorë AB" Shpk është shpallur ankand i fazës së parë për pasuritë dhe mepashimë:  
1- "Tulli-Hidrotor" me sipërfaqe trualli 1328 m2 (në mijë e tetëqind e njëzet e tetë) dhe sipërfaqe ndërtese 508 m2 (pësnëndë e tetë) me Nr.Pasurie 691/31 në Zonën Kadastrale 1167, Vokumi 8, Faqe 94 me adresë Komuna Berzhulë, Tiranë.  
Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 881.600 (tëtoqind e tetëdhjetë e një mijë gjashtëqind) Euro.  
2- "Tulli-Hidrotor" me sipërfaqe trualli 3761 m2 (tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) dhe sipërfaqe ndërtese 1818 m2 (në mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) me Nr.Pasurie 691/30 në Zonën Kadastrale 1167, Vokumi 8, Faqe 93 me adresë Komuna Berzhulë, Tiranë.  
Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Euro.  
Ankandi do të zhvillohet në datë 23.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Shërbimi Përmbarimorë AB" Shpk me Përmbarues Gjyqësor Privat Adnan Boqiri të ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Palli,Kulla 1,Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tiranë

## Axhenda e Palmer, sot takime me Metën, Bashën dhe Kryemadhin

Pas përpjekjeve pa rezultate të diplomacisë evropiane, në lojë për të zgjidhur krizën politike shqiptare është futur edhe diplomacia amerikane. Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën Matthew Palmer nisi axhendën e takimeve të tija dy ditore në kryeministri me kreun e qeverisë Edi Rama me të cilin u takua për rreth 100 minuta. Axhendë më të ngjeshur Palmer do të ketë ditën e martë, ku në mesditë do të takohet me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi, në drekë është parashikuar takimi me kreun e opozitës Lulzim Basha ndërsa rreth orës 17:30 zyrtari amerikan do të



pritet në Presidencë nga kreu i shtetit, Ilir Meta. Pas takimeve me zyrtarët e lartë, mësohet se Matthew Palmer do të ketë një takim edhe me një grup gazetarësh shqiptarë. Palmer vjen në Shqipëri në

një kohë kur opozita e bashkuar ka djegur mandatat ndërsa ka paralajmëruar edhe protesta të vazhdueshme në vend, ndërsa mazhoranca po përgatitet për zgjedhje.

bartë!'. - u shpreh Rama javën e shkuar. Ndërkohë që burime nga kryeministri bënë të ditur dje se gjatë takimit nuk ka pasur propozime konkrete nga Palmer për mënyrën se si mund të dilet nga kjo situatë. Vizita e tij Palmer e gjen Shqipërinë në një moment politik të paprecedent, kur opozita është tërhequr nga parlamenti duke dorëzuar në bllok mandatat e deputetëve të saj dhe ka zgjedhur protestat për të kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie kalimtare që të përgatitë vendin për zgjedhje të parakohshme. Është pikërisht

kjo arsyeja që vizita e Palmer shihet me një interes të veçantë në Tiranë, ndonëse sipas burimeve diplomatike, bëhet fjalë për një vizitë të programuar më parë dhe pjesë e një ture diplomatike të tij në disa vende të rajonit. Gjithsesi duhet theksuar se gjatë muajit shkurt, pas protestës së dhunshme të opozitës para selisë së qeverisë dhe bërjes publike të vendimit për të "djegur mandatat", zyrtari amerikan pati telefonata me dy drejtuesit kryesorë të opozitës, kryetarin demokrat Lulzim Basha dhe kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integrim Monika Kryemadhi. Në

atë kohë Zëri i Amerikës raportoi se Palmer "i këshilloi" dy kryetarët e partive "kundër dorëheqjeve të koordinuara dhe në masë të deputetëve të opozitës nga parlamenti, pasi kjo do të dëmtojte përpjekjet për reforma dhe do të dëmtojte një institucion të rëndësishëm të demokracisë" si dhe të hedhin poshtë dhe të dënojnë publikisht gjithë dhunën. Gjithsesi Palmer qëndrimin amerikan pritet t'ia konfirmojë edhe një herë sot publikisht liderëve të opozitës, ndërsa do të diskutojë edhe për një zgjidhje të mundshme të krizës.

## AKSIONI I OPOZITËS PROTESTA

Kreu i PD mbledh ish-deputetët dhe forumet: Më 13 prill të jemi më shumë

Valentina Madani

Opozita ka intensi fikuar përpjekjet për një pjesëmarrje sa më të lartë në protestën e 13 prill kundër qeverisë "Rama", strukturat angazhim maksimal që protesta e 13 prillit të jetë më masive. Kërkesa vijon të mbetet e pandryshueshme, zgjedhje të parakohshme dhe qeveri tranzitore pa Edi Ramën. Do të jetë kjo qeveri, sipas Bashës, që do të garantojë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Lulzim Basha thirrri dje në një takim Kryesinë e më pas edhe Këshillin Kombëtar bashkë me ish-deputetët, ku iu kërkoi angazhim për të bindur qytetarët që të bashkohen në shesh para Kryeministrit. Por organizimi për tubimin e pasdites së 13 prillit duket se nuk do të ndalojë demokratët në mbajtjen e protestës, tashmë të përjavshme, përpara godinës parlamentare gjatë zhvillimit të seancës plenare. Z.Basha bëri thirrje për një protestë më masive, krahasuar me dy protestat e kaluara kombëtare, pasi sipas tij e gjithë situata është në favor të PD-së. Për Bashën, djegia e mandateve dhe protestat e zhvilluara, kanë ndikuar në rritje të mbështetësve demokratë. Ai risolli në vëmendje një qeveri tranzitore pa Edi Ramën kryeministër, për t'u përgatitur më pas për zgjedhje të parakohshme. "Për protestën e 13 prillit duhet një organizim kapilar për ta patur pjesëmarrjen edhe më të madhe se dy protestat e tjera kombëtare". mësohet të jetë shprehur Basha, në mbledhjen me dyer të mbyllura. Lulzim Basha ka përmendur se pas djegies së mandateve dhe daljen në rrugë opozita është shumicë, e këtë bindje ai e ka forcur pas sondazheve të publikuara në media. "PD ka një rritje të menjëhershme edhe mes të pavendosurve. Jemi shumicë absolute në çdo sondazh të pavarur vendas dhe të huaj. Duhet ta përkthejmë sa më shpejt në votë këtë mbështetje të shqiptarëve. Për këtë arsye, pjesëmarrja e lartë në protestë ka një rëndësi të jashtëzakonshme, kërkesa jonë mbetet e pandryshueshme: largimi i Edi Ramës dhe qeveri tranzitore. Ta shpejtojmë në çdo takim që ne jemi shumicë dhe duhet ta tregojmë këtë", deklaroi kreu i PD-së. Z.Basha, u kërkoi strukturave që të angazhohen dhe të intensifikojnë në takimet me qytetarët, ku, siç është shprehur ai, për t'i bindur për alternativën e opozitës dhe për ta përkthyer në votë. Pas mbledhjeve në selinë blu, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha, shkoi në Kurbin dhe Kukës, Tropojë e Dibër, ku zhvilloi takime me strukturat e partisë. Basha ftoi qytetarët që të marrin pjesë në protestën

# Basha fton shqiptarët: Ejani në Tiranë të rrëzojmë Ramën

Berisha: Lider bëhesh ditën që fiton zgjedhjet



Kryesia e PD-së

### TAKIMET

Kreu i PD-së pas mbledhjes me forumet e partisë shkoi në veri dhe verilindje të vendit në disa takime me strukturat në Kurbin, Kukës, Has, Tropojë e Dibër, ku ftoi qytetarët që të marrin pjesë në protestën e 13 prillit. "E shtuna e 13 prillit do të jetë goditja e fortë ndaj Edi Ramës, e hajdutëve dhe e oligarkëve, zgjedhje të parakohshme", - tha Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë një proteste të opozitës

## Vendimi, Tabaku: Familjet fituan dëmshpërblimin nga këshilli bashkiak

Ish-deputetja demokratike, Jorida Tabaku, e cilësoi si të tmerrshme dhunën e ushtruar dje ndaj banorëve të Bregut të Lumit, të cilët sipas saj në fund të fundit po kërkojnë një të drejtë të tyre. "Projekti i Bulevardit të Ri që filloi në vitin 2013, me fonde të siguruar nga Lulzim Basha, mbi 200 banesa me VKM u dëmshpërblen dhe me banorët me gjithë pakënaqësitë që patën dhe konfliktet, dolën nga banesat e tyre, ndërkohe që Bashkia e Tiranës qëkur ka ardhur Erion Veliaj dhe deri më sot nuk ka marrë asnjë masë të vetme për të dëmshpërblyer këto 38 familje të mbetura që është loti i tretë i Bulevardit.



Këto 38 familje kanë vendimin e Këshillit Bashkiak për dëmshpërblimin e tyre. Këto po kërkojnë vetëm një standard të dëmshpërblenjes të respektohen ligjet e shtetit. Kjo është e tmerrshme që po ndodh. Banorët nuk kanë asnjë njoftim për të dalë nga shtëpia, nuk kanë asnjë vendim për të prishur

shtëpitë, dhe sot kishin shkuar 300 policë për t'u prishur shtëpitë, kishte shkuar RENEA, dhe ushtrorin dhunë ndaj grave dhe vajzave që mbrojnë shtëpitë e tyre. Këta po kërkojnë thjesht të respektohen e drejta e tyre sikundër pjesa tjetër e 200 familjeve që janë dëmshpërblyer. Po t'i shikosh shtëpitë e tyre ato nuk janë shtëpitë 3 apo 4 katëshe, nuk jeton as Klement Balli as Agron Xhafaj. Aty banojnë banorët të thjeshtë që kanë 26 vite që jetojnë aty. Po, kur kam parë sot, që policia u gjuante atyre grave dhe vajzave me shkop gome, u shokova", -tha Tabaku.

## PD, Alibeaj: Me bandat të përballlemi dhëmb për dhëmb

Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj iu bashkua dhe protestës së banorëve të Bregut të Lumit që kundërshtojnë prishjen e banesave për zgjatimin e Bulevardit të Ri. Alibeaj tha se me 'bandat' duhet të përballen vetëm dhëmb për dhëmb. Kjo mënyrë, sipas tij, funksionoi me banorët e Astrit dhe do funksionojë edhe me banorët e Bregut të Lumit. "Ju mendoni se bandat njojnë orar zyrtar? Bandave dhëmb për dhëmb. Du për një kokë. Kjo është e vetmja zgjidhje dhe që funksionon. Funksionoi tek Astiri, do funksionojë këtu dhe për gjithë shqiptarët", tha z.Alibeaj. Një grup ish-deputetësh demokratë ishin dje pranë banorëve të Bregut të Lumit, pas një vendimi të marrë menjëherë pas përfundimit të mbledhjes së kryesisë së Partisë Demokratike. Ndërkohë protestës u janë bashkuar, që në nisje të saj, ish-deputetët demokratë Jorida Tabaku dhe Klevis Balliu. Banorët e Bregut të Lumit që preken nga zgjatja e Bulevardit të Ri u përplasen me policinë me gurë e lopata. Ish-deputeti i PD-së, Klevis Balliu i pranishëm në rezistencën e banorëve të Bulevardit të Ri, shtëpitë e të cilëve preken nga projekti i Unazës së Madhe, u shpreh se policia me urdhër të Ramës i ka dhunuar. Sipas Balliut, kryeministri Rama me dëshirën e tij të plotë vendosi ju vetëm të mos i dëmshpërblen por edhe t'i shkatërron banesat e këtyre banorëve.



e 13 prillit para selisë së qeverisë në orën 18:00. "E shtuna e 13 prillit do të jetë goditja e fortë ndaj Edi Ramës, e hajdutëve dhe e oligarkëve, zgjedhje të parakohshme. Qytetarët po përgatiten për një bashkim mbarëkombëtar, për t'i hapur rrugë Shqipërisë europiane, zgjidhje politike" - theksoi z.Basha.

**KËSHILLA**  
Në mbledhjen e djeshme me forumet e partisë në mbështetje të Lulzim Bashës ishte ish-kryeministri Sali Berisha, i cili përmendi se PD-ja është shumicë. Por ish-kryeministri gjatë mbledhjes së Kryesisë së partisë është

shprehur se Basha së pari, duhet të fitojë zgjedhjet për të hedhur poshtë dyshimet për këdo që është skeptik. Burime brenda mbledhjes bëjnë me dije se ish-kryeministri Sali Berisha, këshilloi Bashën: "Është normale që partia të dalë edhe mbi liderin. Lider bëhesh ditën që con partinë në fitore dhe fiton zgjedhjet. Deri kur të shkohet në atë moment, shpesh të duhet t'i futesh detit në këmbë. Atëherë kur do të fitosh zgjedhjet të gjithë do të kërkojnë ndjesë". Po dhe ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi se kryeministri Edi Rama ka porositur mbledhjen

e qindra mijërave fidanëve kanabis, me qëllimim e vetëm blerjen e zgjedhjeve lokale. Sipas Berishës, një urdhër i tillë jepet pak para zgjedhjeve lokale dhe për të zbutur pakënaqësinë që ekziston ndaj qeverisë aktuale. Z.Berisha rikujton se vatrë e zjarrit të përhapura gjerësisht në vendin tonë, janë bërë vetëm e vetëm për mbjelljen e lëndëve narkotike. Ish-kryeministri nuk ngurron t'i bëjë thirrje, Interpol, Europol, agjencive të tjera që luftojnë drogën nga vendet partnere të ndërhjajnë për të bllokuar këtë situatë, e cila sipas tij mund të ketë pasojë

shkatërrimtare për vendin tonë. "Porositen qindramijëra fidanë dhe po përgatiten mbjellje të mëdha kanabis! Burime shumë mirë të informuara njoftojnë se narkoqeveria e narkoshtetit ka vendosur të nxisë përsëri mbjelljen masive të kanabisit në Shqipëri për të zbutur pakënaqësinë masive që ekziston sot ndaj qeverisë dhe zbutur shkallën e revoltës në rritje të masave kundër narkoqeverisë", shkruan z.Berisha në "Facebook". Ai shton më tej: "Qëllimi i dytë i këtij operacioni më megakriminal të kobshëm që u parapri nga qindra e qin-

dra zjarre në mars si kurrë ndonjëherë me parë (për të hapur qindra e qindra hektarë për hashash) është përdorimi i mbjelljeve dhe produkteve të hashashit për qëllime të blerjes së zgjedhjeve që po duken në horizont. I bëj thirrje Interpolit, Europolit, agjencive të luftës kundër drogës të venden partnere të marrin çdo masë dhe ushrojnë çdo presion kundër narkoqeverisë dhe narkoshtetit shqiptar dhe të bllokojnë këtë mega afërë me pasojë shkatërrimtare për Shqipërinë, por tejet të dëmshme edhe për rajonin".





Mbi 20 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë kanë fshehur pasuritë. Kjo e dhënë vjen nga kreu i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, Shkëlqim Ganaj, i cili gjatë një interviste për "A2 CNN" ka bërë të ditur se bëhet fjalë për deputetë që kanë ushtruar mandatin kryesisht gjatë viteve të fundit. "Jo një, por ka disa raste, të cilat i janë referuar prokurorisë, organeve të specializuara të hetimit tatimor, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. I përkasin të gjitha krahëve politike. Mund të jenë mbi 20 raste. Janë zbuluar gjatë verifikimeve të 3-4 viteve të fundit", - tha Ganaj. Ai bëri të ditur puna e madhe me të cilën është dashur të përballët ILDKP edhe për të plotësuar detyrimet i kanë lindur

**Nga 2020-ta, verifikimi i pasurisë, jo më në mënyrë manuale**

**Flet kreu i LDKPI-së, Ganaj: Mbi 20 deputetë kanë fshehur pasurinë**



Kreu i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, Shkëlqim Ganaj

nga zbatimi i reformës në drejtësi. "Janë në proces, por mbani parasysh edhe ngarkesën që ka pasur stafi i institucionit. Njerëz punojnë edhe këtu, nuk punojnë robotë. Vetëm për procesin e vetingut të prokurorëve dhe gjyqtarëve

nga kemi përpunuar 1.2 milionë faqe dokumente, në mënyrë nominale nga punonjësit", tha Ganaj. Por, procedurat manuale të verifikimit do të zhduken brenda 2020-s, ndërsa pas përpunimit të informacionit, deklaratat e pasurive të 3000

zyrtarëve do të publikohen online në faqen e Inspektoratit. "Komisioni Europian po përfundon progres-raportin për 2018-en, në të cilin ne do të shtjellojmë dhe pasqyrojmë përpjekjet që ka bërë Shqipëria kundër korrupsionit. Iniciativa e ditës së sotme do të jetë pjesë e këtij raporti, sepse do ta bëjë verifikimin më të shpejt dhe transparent. Pasi deklaratat e pasurive të publikohen, të gjithë do të kenë mundësi të shohin sa të ndërshejmë janë zyrtarët e tyre", - u shpreh Luigi Soreca. Sistemi elektronik për deklarimin e interesave private të të zgjedhurve dhe nëpunësve të lartë publikë u financua nga BE-ja dhe USAID-i.

**Blerina Gjylameti ka paraqitur dje kërkesën për regjistrimin e Partisë Socialiste**

Partia Socialiste është e vendosur që të shkojë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit edhe nëse opozita do t'i bojkotojë ato. Për të treguar këtë, nuk kanë mjaftuar vetëm deklaratat e herëpashershme të drejtuesve të saj, por ajo ka vendosur të bëjë tashmë edhe një hap konkret në këtë drejtim. Dje Partia Socialiste ka paraqitur kërkesën për t'u regjistruar zyrtarisht si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për kryetar bashkie, që janë deklaratuar të mbahen në 30 qershor. Kërkesa mban datën e djeshme dhe është paraqitur nga sekretarja e Koordinimit Elektoral në Partinë Socialiste, Blerina Gjylameti. Krahas kërkesës zyrtare, PS e ka shoqëruar atë edhe me një sërë dokumentesh ligjore të nevojshme për regjistrim, si vendim gjykatë, emrin dhe mbiemrin e plotë të kryetarit të partisë, emrin e financierit etj. Sipas burimeve nga KQZ-ja, bashkë me Partinë Socialiste janë paraqitur ose janë regjistruar deri më tani plotësisht 16 parti politike, thuhet të gjitha aleatë të socialisteve, me përjashtim të ndonjë partie të pozicionuar. Kështu, deri më tani KQZ-ja ka regjistruar me vendim komisioni 11 parti, ndërmjet të cilave: Partia e të Drejtave të Mohuara, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Partia e Personave me Aftësi me të Kufizuara dhe Personave me Aftësi me të Kufizuara, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Uniteti Kombëtar, Partia Kristian Demokratë, Partia Aleanca Demokratiane dhe Partia e Gjelbër.

**Lokalet pa opozitën, PS regjistrohet në KQZ për zgjedhjet e qershorit**

*Deri më tani kanë paraqitur kërkesë vetëm 16 parti*



**PARTITË E REGJISTRUARA NË KQZ PËR ZGJEDHJET E 30 QERSHORIT**

- Partia e të Drejtave të Mohuara
- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve
- Partia e Personave me Aftësi me të Kufizuara
- Partia Kombëtare Konservatore Albania
- Partia Emigracioni Shqiptar
- Partia Socialiste e Moderuar
- Partia Uniteti Kombëtar
- Partia Kristian Demokratë
- Partia Aleanca Demokratiane
- Partia e Gjelbër

regjistrimin, por nëpërmjet këtij vendimi kërkon që t'i tregojë opozitës se është e vendosur që të shkojë në

zgjedhje edhe pa të dhe nga ana tjetër, t'u përcjellë një mesazh të qartë edhe aleatëve të vet që të regjistro-

hen në KQZ brenda afateve ligjore. Kujtojmë këtu që kërkesa për regjistrimin në KQZ brenda afatit ligjor u bë pjesë edhe deklarates së bashkë të tryezës së partisë të koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", ku i kërkohej të gjitha partisve të këtij koalicioni të regjistroheshin në zgjedhje. Por, pavarësisht përpjekjeve të PS për të nxitur partisë të tjera që të regjistrohen, deri më tani asnjë forcë politike kryesore nga kampi opozitar nuk ka paraqitur kërkesë në KQZ. Ato deri më tani kanë injoruar detyrimet që përcajton Kodi Zgjedhor, duke mos përmbyshur asnjë detyrim. Kështu, PD dhe LSI jo vetëm që nuk janë regjistruar (për këtë nuk mund t'i akuzosh se kanë ende kohë ligjore), por nuk kanë paraqitur as kandidatët për anëtarë të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë, KZAZ. 21 Prilli është afati i fundit për regjistrimin e partisve politike në KQZ, ndërsa 10 ditë më pas përfundon afati për regjistrimin e koalicioneve. Sipas Kodit Zgjedhor, depozitimi i listave shumëmbrojtëse të kandidatëve për kryetarë bashkish dhe këshillat bashkiakë duhet të bëhet jo më vonë se data 13 maj.

**Reforma, ambasadorët: Duhet diplomatë karriere, jo ekselentë**

Reforma në Shërbimin Diplomatik, e iniciuar nga Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, nuk është pritur mirë nga diplomatët shqiptarë. Këshilli i Ambasadorëve të Shqipërisë, ku bëjnë pjesë figura të shquara dhe me peshe të diplomacisë shqiptare, ka reaguar ashpër ndaj kësaj nisme, e cila sipas tyre nuk zbaton ligjin. Në një deklaratë të Këshillit të Ambasadorëve duke iu referuar thirrjes publike të MEPJ për punësim pranë përfaqësive diplomatike të ekspertëve ekselentë, thuhet se shërbimi diplomatik ka nevojë të konsolidohet me diplomatë karriere, që i promovon dhe i mbrojnë ligji dhe jo për prurje nga jashtë pa respektuar ligjin. Sipas Këshillit të Ambasadorëve, vetëm eksperiencia, vlerësimet në punë dhe karriera në shërbimin e jashtëm janë kriteret themelore që duhen marrë në konsideratë. Ndaj, ky këshill kërkon zbatimin e ligjit për shërbimin e jashtëm dhe rregullores. "Shërbimi diplomatik ka nevojë të konsolidohet me diplomatë karriere, që i promovon dhe i mbrojnë ligji dhe jo për prurje nga jashtë pa respektuar ligjin. Përjashtim nuk mund dhe nuk duhet të përbëjnë edhe studentët 'ekselentë'. Një student i shkëlqyer, apo siç e konsideron MEPJ, 'ekselent' është thjesht një student që ka mbaruar studimet dhe që duhet të motivohet të aplikojë për të filluar karrierën e tij sektoriale apo akademike. Vetëm eksperiencia, vlerësimet në punë dhe karriera në shërbimin e jashtëm janë kriteret themelore që duhen marrë në konsideratë", thuhet në këtë deklaratë. Në fund, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i bën thirrje MEPJ të respektojë ligjin në fuqi, si dhe të fillojë procedurat për ta riparë këtë ligj, me qëllim shkëputjen një herë e përgjithmonë nga emërimet që jo vetëm nuk e përmirësojnë, por e dëmtojnë trupën tonë diplomatike.

**AFATI**  
21 prilli është afati i fundit për regjistrimin e partisve politike në KQZ, ndërsa 10 ditë më pas përfundon afati për regjistrimin e koalicioneve. Sipas Kodit Zgjedhor, depozitimi i listave shumëmbrojtëse të kandidatëve për kryetarë bashkish dhe këshillat bashkiakë duhet të bëhet jo më vonë se data 13 maj.

Njëri nga të arrestuarit, Elvis Gaçaj, u shpëtoi 3 atentateve me armë dhe eksploziv

# Trafik kokaine drejt Gjermanisë, përfundojnë në pranga katër anëtarë të një grupi kriminal

*Policia: Leonard Duka "koka" e grupit, dyshohet se do të bënin atentat në Tiranë*

TIRANË

Një grup i strukturuar kriminal, i përfshirë në trafikun ndërkombëtar të drogës është goditur dje nga policia e Tiranës. Mësohet se grupi me bazë në kryeqytet trafikonte kokainë në drejtim të Gjermanisë, ndërsa merrej edhe me shpërndarjen e lëndëve narkotike. Gjatë superaksionit të policisë kanë përfunduar në pranga katër persona, përfshirë kreun e grupit, Leonard Duka; pjesëtarë Elvis Gaçaj, ndaj të cilit është kryer atentat në vitin 2015, si dhe Oltion Logajn dhe Dritan Agaj. Urdhër-arrestet janë firmosur nga Prokuroria për Krime të Rënda, ndërkohë që janë kryer një sërë kontrollesh në disa banesa në kryeqytet. Sipas policisë, të arrestuarit janë persona me precedentë penalë dhe me të shkurra të errët. Arrestimi është bërë në një banesë të marrë me qira, pranë shkollës "Partizani", në zonën e Medresesë. Aksioni i djeshëm u krye për të parandaluar një vrasje, e cila ishte planifikuar dhe do kryhej nga ky grup personash. Gjatë operacionit, policia sekuestroi një armë zjarri, 10 celularë dhe 2 automjete, njëri prej tyre tip "BMW" seria 7-të dhe me targa ruse i blinduar, i marrë me qira. Personat në fjalë ishin prej kohësh nën hetim dhe nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Seksioni i Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Krimeve të Rënda ndaj Jetës në D.V.P Tiranë, pas informacioneve të siguruar në rrugë operative për disa persona që dispononin armë e drogë, arrestoi në flagrancë shtetasit: Leonard Duka, 33 vjeç, banues në Tiranë; Dritan Agaj, 38 vjeç, banues në Tiranë; Oltion Loga, 38 vjeç, banues në Tiranë; Elvis Gaçaj, 44 vjeç, banues në Tiranë, thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë së kryeqytetit. Gjatë kontrollit të ushtruar nga blutë, këta shtetas janë munduar të largojnë sendet e kundraligjshme duke hedhur një pjesë të tyre nga ballkoni i banesës. Ndërkaq, mësohet se personat e vënë në pranga akuzohen për veprat



I arrestuari, Elvis Gaçaj



Makina e blinduar e sekuestruar nga policia

penale "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve e municionit luftarak e kryer në bash-

këpunim". Po sipas burimeve policore, 32-vjeçari Leonard Duka është përfshirë në disa ngjarje të mëparshme kriminale, ku ai së

bashku me vëllain Eduard Duka kanë tentuar t'i bëjnë atentat një personi, të cilit i shpëtoi dhe prej asaj kohe janë shpallur në kërkim.

Ndërsa, ndaj Ervis Gaçaj janë organizuar tri atentate, dy me eksploziv dhe një me armë. Blutë pohan se ai ka shpëtuar në të tria rastet, por në atentatin me eksploziv ka mbetur i plagosur. Ndërkohë, dyshohet se Leonard Duka ishte koka e bandës.

## I ARRESTUARI LEONARD DUKA

32-vjeçari është personazh i njohur për policinë. Ai bashkë me vëllain e tij kanë plagosur shtetasin Eduard Duka, 34 vjeç, ngjarje kjo e ndodhur më 20 mars të vitit 2017. Një ditë pas ngjarjes, policia e shpalli në kërkim autorët dhe që prej asaj kohe, ata ishin në kërkim. Pavarësisht mbiemrit Duka, autorët dhe i plagosuri nuk kishin lidhje farefisnore midis tyre. Policia bëri me dije në atë kohë se i plagosuri ka marrë dy plumba në krah, ndërsa ndaj tij është qëlluar 3 herë me një pistoletë të kalibrit 7.65 milimetër. Vetë 34-vjeçari ka pohan nga Spitali i Traumës se nuk ka probleme me persona të tjerë, përveç dy vëllezërve, me të cilët ishte konfliktuar fizikisht më datë 8 shkurt të vitit 2017. Në momentin që ndodhi ngjarja, Duka ndodhej në shoqërinë e dy personave. Autorët kanë qëlluar nga makina në drejtim të tij, më pas janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. "Shtetasit e shpallur në kërkim me shtetasin e dëmtuar, më parë kanë pasur një konflikt midis njëritjetrit dhe konkretisht më datë 8 shkurt 2017, konflikti i cili është trajtuar nga komisaritari nr. 4. Po punohet për kapje e autorëve të dyshuar të ngjarjes. Materialet procedurale i kaluan prokurorisë për veprat pe-

nale 'Vrasje me paramendim, mbetur në tentativë, në bashkëpunim' dhe 'Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit', bënte me dije policia e Tiranës në atë kohë.

## I ARRESTUARI ELVIS GAÇAJ

Edhe Elvis Gaçaj është një emër i njohur për drejtësinë shqiptare. Ai është dënuar dy herë për krime të rënda (vrasje e tentativë vrasje) si dhe është hetuar edhe për trafik droge brenda e jashtë Shqipërisë. Gaçaj është dënuar për vrasje në vitin 1992. Ai ishte adoleshent kur vrau me thikë shokun e tij. Duke e goditur në njërën kofshë, i prer arterien kryesore dhe për pasojë bashkëmoshatarë gjeti vdekjen në spital. Për këtë ngjarje ai është dënuar me 14 vjet burg, dënim të cilin e ka përfunduar para disa viteve. Vetëm pak muaj pasi kishte dalë nga burgu, në vitin 2008, Gaçaj përfundon sërish në pranga. Më 30 shtator të vitit 2008, Policia e Tiranës njoftonte se specialistët e Seksionit Kundër Krimeve ndaj Jetës dhe Shëndetit kishin arrestuar shtetasin Elvis Shpëtim Gaçaj, në atë kohë 32 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i dënuar më parë për vrasje. Sipas policisë, Gaçaj ishte arrestuar si autor i dyshuar për plagosjen për motive të dobëta të shtetasit Sefer M., ngjarje kjo e ndodhur me datë 26 korrik 2008. Nuk përfundojnë këtu problemet e tij me drejtësinë. Më 1 tetor të vitit 2015 u organizua një atentat ndaj tij, duke u vranë gabimisht dy persona të tjerë. Ndaj Gaçajit ishin organizuar edhe dy atentate të tjera të kryera me eksploziv, por që kishte arritur të mbijetonte. Plumbat e nisur për Gaçajin i morën jetën të dashurës së tij dhe 22-vjeçarit që punonte për të. Ai vetë shpëtoi me dy plagë të lehta në shpatull e në dorë, ndonëse autorët i kanë shkrëpur armët plot 29 herë. Për ngjarjen, policia arrestoi shtetasit Sael Sulaj, 20 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë dhe Vasiel Cavo, 23 vjeç, lindur në Tropojë dhe banues në Tiranë. Konflikti midis tyre kishte lindur për shkak se Gaçaj u kishte kërkuar të punonin për të për të shpërndarë lëndë narkotike në zonën e stadiumit "Dinamo" në Tiranë, por të rinjtë nuk kishin pranuar. Ata më pas u rrahën nga Gaçaj. Sael Sulaj është dënuar me 35 vite burg dhe Vasel Cavo me 20 vite burg.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 09 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

| Nr | Përshkrimi i Produktit  | Çmimi prej datës 09.04.2019 (përfshirë TVSh-në) |
|----|-------------------------|-------------------------------------------------|
| 1  | HEETS (AMBER LABEL)     | 320 Lekë/paketë                                 |
| 2  | HEETS (BRONZE LABEL)    | 320 Lekë/paketë                                 |
| 3  | HEETS (TURQUOISE LABEL) | 320 Lekë/paketë                                 |
| 4  | HEETS (YELLOW LABEL)    | 320 Lekë/paketë                                 |

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbivlerën e shtuar"" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670



Seanca ku do të lexohen konkluzionet e mbrojtjes u caktua më 23 prill

# Jepet pretenca për "Eskobarin e Ballkanit", Prokuroria e Krimeve të Rënda: 18 vite burg

*Në rast të shpalljes fajtor, Kelmend Balilit i ulet dënimi në 12 vite për shkak të gjyqimit të shkurtuar*

TIRANË

Pas dështimit të tri seancave gjyqësore, prokurori Ened Nakuçi dhe dje pretencën për Kelmend Balilin, i konsideruar si "Eskobari i Ballkanit". Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkoi dënimin e tij me 18 vite burg. Ndërkohë që më herët, Gjykata për Krime të Rënda pranoi kërkesën e Balilit për gjykim të shkurtuar që i jep të drejtën Balilit të përfitojë ulje të dënimit, në rast të shpalljes fajtor. Nga gjykimi i shkurtuar kërkesa shkon në 12 vite heqje lirie. Ish-zyrtari i lartë akuzohet për trafik narkotikësh në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, fshehje të pasurisë dhe pastrim të parave. Si prova fajësie u renditen përgjimet telefonike të realizuara nga autoritetet greke në kuadër të një hetimi që po kryhej atje për një organizatë kriminale që trafikonte hashash e kokainë. Nëse gjykata do të vendosë ta shpallë fajtor Balilin dhe të pranojë pretencën e prokurorisë, ai përfiton edhe nga gjykimi i shkurtuar, duke u dënuar me 12 vite burg. Konkretisht, organi i akuzës kërkoi shpalljen fajtor të 47-vjeçarit për trafik lëndësh narkotike dhe dënimin me 10 vite burg, deklarimin fajtor për pastrim parash dhe dënimin me 5 vite burg, deklarimin fajtor për fshehje të pasurisë dhe dënimin me 6 muaj dhe deklarimin fajtor për grup kriminal dhe dënimin me 5 vite burg. Seanca kur do të lexohen konkluzionet e mbrojtjes u caktua në 23 prill, në orën 12:30. Sipas organit të akuzës, gjatë hetimit nga homologët grekë është identifikuar një person me emrin Keli, që më vonë ka rezultuar se ishte Kelmend Balili. Ky i fundit sipas institucionit të akuzës, ka pasur rolin e organizatorit në trafikimin e një sasive prej rreth 700 kg hashash nga Shqipëria drejt Greqisë, atje ku edhe u arrestuan dy shtetas shqiptarë. Në kërkesën për gjykim binte në sy fakti, se Balili ishte kallëzuar nga ILDKPI për fshehje pasurie, disa muaj pasi ishte shpallur në kërkim. Kelmend Balilijetoi për dy vite në arrati për t'u vetëdorëzuar më 15 janar të këtij viti pas negociatave me policinë. Ai mohon të jetë përfshirë në veprimtari kriminale dhe këmbëngul për pajfajësi.

**HETIMET**

Më shumë se dy vite kanë zgjatur hetimet për njeriun, që shpesh është konsideruar si "Eskobari i Ballkanit", ndërsa pjesa më e madhe e hetimeve duket se është e bazuar në përgjigjet e marra nga letërporositë e dërguara në Greqi. Prokuroria për



Kelmend Balili

Krime të Rënda ka një sërë përgjimesh të grupit, ku Balili dyshohet se ka qenë një nga financuesit. Emri i këtij të fundit, si i përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike është lakuar nga politika dhe media greke në momentin që ai ishte në krye të Drejtorisë së Transportit Rrugor në Sarandë, në vitin 2016. Pas këtyre të dhënave të bëra publike në atë kohë, Prokuroria e Krimeve të Rënda me shkresë Nr.112/1 prot., datë 11.05.2016 kërkoi përcjelljen e letërporositë për ndihmë juridike, drejtuar autoriteteve greke të drejtësisë, për të marrë informacion për Klement Balilin. Referuar dosjes hetimore, ka qenë rasti i trafikimit të një sasive prej 700 kg kanabis sativa nga Saranda drejt një ishulli në Greqi, që ka nxjerrë Balilin në përgjimet e autoriteteve greke. Sipas këtyre përgjimeve, dyshohet se Klement Balili mbante kontakte me dy skafistë dhe pritësin e sasisë së lëndës narkotike në Greqi. Pritësi rezultoi të ishte një biznesmen në shtetin fqinj dhe është vënë në pranga gjatë këtij operacioni, së bashku me dy skafistët, ndërsa në atë kohë është bërë edhe shpallja në kërkim e Klement Balilit. "Me shkresë Nr.4264KL/6, Prot. FKB, datë 17.05.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana) ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe ka vënë në dije-

ni Prokurorinë e Përgjithshme 'Mbi shpalljen në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Athina', po në datë 17 maj 2016 të shtetasit shqiptar Klement Balili, në bazë të urdhërarrestit nr.FE7698, viti 2016, për veprën penale 'Krijim dhe drejtim Organizate Kriminale', njoftonte dy vite më parë Ministria e Drejtësisë.

**ITALI** - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, policia italiane në bashkëpunim me atë angleze kanë nisur të zbatojnë vendimin e Gjykatës së Romës për 18 persona, pjesë e një bande të rrezikshme të trafikut të armëve, por jo vetëm. Kështu, 11 prej tyre kanë përfunduar në burg, 2 janë në arrest shtëpie dhe 5 të tjerë në detyrim paraqitje. Mbi këtë grup, pjesa më e madhe e të cilëve ishin shqiptarë, rëndojnë akuzat për nxitjen e emigracionit të paligjshëm, trafikun ndërkombëtar të drogës dhe trafikut të armëve. Ishin karabinierët e Frascatis, ata që zbuluan ekzistencën e bandës, e cila fillimisht ishte marrë me trafikun e sasive të mëdha të marijuanës që vinte nga Shqipëria, e që kishin lidhje me një tjetër grup kriminal që shërbente më pas si "urë lidhëse" mes

**KONFISKIMI I PASURISË**

Pak ditë më parë, Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar konfiskimin e pasurive të Kelmend Balilit, i cilësuar si "Eskobari i Ballkanit". Organi i akuzës i është drejtuar përmes një kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurisë së Balilit i vënë nën akuzë për një sërë veprash penale. Bëhet fjalë për një truall me sipërfaqe 11.994 m2 në qytetin e Sarandës; kompleksin luksoz "Santa Quaranta" (ish-Kampi i Pushimit të Punëtorëve 4+1 kate me sipërfaqe ndërtimi 1923 m2 dhe sipërfaqe trualli 13.000 m2) ndodhur në qytetin e Sarandës; truall me sipërfaqe 1716.91 m2 me ndodhur në qytetin e Sarandës, njësi me sipërfaqe 120 m2 si dhe 23 apartamente.

**AKUZAT**

1. "Trafikimi i lëndëve narkotike", i kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal.
2. "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal".
3. "Refuzim për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim".
4. "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".



Prangoset shqiptari, shantazhoi me foto nudo 14-vjeçaren

**GREQI** - Mediat greke raportojnë se një shqiptar 20-vjeçar u arrestua në Greqi, pasi shantazhonte një vajzë 14-vjeçare me fotografi nudo. I riu i arrestuar jetonte në ishullin e Peloponezit. Shqiptari kishte arritur t'i merrte të miturës një foto, ku ajo ishte gjysmë e zhveshur. Pas kësaj, ai e kërcënonte se në rast se nuk i dërgonte foto të tjera të ngjashme, do t'i nxirrte fotot në internet. Policia greke bastisi shtëpinë e të riut nga Shqipëria dhe i gjeti atij qindra foto nudo të vajzave të mitura të zhveshura dhe gjysmë të zhveshura.

## Trafik droge e armësh nga Italia në Angli, shkatërrohet banda me shqiptarë



grupeve në Itali dhe atyre në Angli, duke u mundësuar kalimin e paligjshëm qytetarëve shqiptarë. Falë bashkëpunimit mes dy policive, u arrit të ndalohej një grua shqiptare në aeroportin e

Londrës që përdorte kartën e identitetit të një shtetaseje italiane, e cila i ishte vënë në dispozicion nga grupi kriminal. Baza e bandës ishte në provincën e Romëve, midis komunave Guidonia

dhe Fonte Nuova. Falë përgjimeve telefonike dhe mjedisore, policia mundi të identifikonte blerës të ndryshëm që blinin marijuanë nga ky grup. Gjatë ndërhyrjes është gjetur jo vetëm një sasi e konsiderueshme marijuane, por edhe një helikopter AK-47, që dyshohet se përdorej për aktivitetet e jashtëligjshme të bandës. Gjatë përgjimeve, policia zbuloi disa raste të shtetasve shqiptarë që pasi i merrnin nga Shqipëria, iu ndryshonin identitetin me atë të shtetasve të tjerë italianë, për të hyrë në këtë mënyrë në Angli. Me të shkuar atje, anëtarë të organizatës kujdeseshin të gjenin edhe një vend strehimi për qytetarët me dokumente të parregullta.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës/Lista me pronarët që kompensohen për truallin e zënë nga ndërtimet informale

# Tokat e zëna, 300 pronarë marrin 107 milionë lekë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

Qeveria ka miratuar kompensimin financiar të pronarëve që preken nga ndërtimet informale. Janë në total 300 pronarë, të cilët do të marrin në total mbi 107 milionë lekë. Përfituesit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Masa e kompensimit është 14 621,33 m<sup>2</sup> dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 107 503 583 lekë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve së bashku me shumën për çdo pronar. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të

ardhura që arkëtohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës. Pronari plotëson një kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I in-

teresuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e

trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sille certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i

lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare, ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. Qeveria ur-

dhëron Zyrat Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht në Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

| Kompensimi i Pronarëve |       |         |               |                |                                      |                              |                                   |
|------------------------|-------|---------|---------------|----------------|--------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| Emër                   | Atësi | Mbiemër | Nr. i pronave | Nr. i pasurisë | Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> ) | Çmimi (leke/m <sup>2</sup> ) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |

|         |         |            |   |       |        |        |              |
|---------|---------|------------|---|-------|--------|--------|--------------|
| DIANA   | FASLLI  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| FLORIAN | FASLLI  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| FATBAR  | ABEDIN  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| VERA    | BAJRAM  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| DORIAN  | NESTOR  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| ARIANA  | NESTOR  | NEPRAVISHT |   |       |        |        |              |
| RREZAR  | DILAVER | TARTARI    |   |       |        |        |              |
| URAN    | DILAVER | TARTARI    |   |       |        |        |              |
| ZANA    | ARIF    | TARTARI    |   |       |        |        |              |
| ANRI    | ADMAND  | TARTARI    | 1 | 2/380 | 16.90  | 66,969 | 1,317,76.10  |
| ASTRIT  |         | XHEBRAHIMI | 2 | 2/430 | 50.20  | 66,969 | 3,361,843.80 |
| MYZEJE  | ALI     | BENGASI    |   |       |        |        |              |
| EDUART  | BEHAR   | BENGASI    |   |       |        |        |              |
| ERVIS   | BEHAR   | BENGASI    | 3 | 63/60 | 500.00 | 472.00 | 236,000.00   |
| ZYBER   | KAMBER  | BENGA      | 4 | 563   | 372.7  | 3283   | 1,223,574.10 |
| DION    | ALI     | ARAPI      | 5 | 9/9   | 500.5  | 324    | 162,162      |
| AGIM    | SABRI   | MULLAJMERI | 6 | 10/3  | 192.00 | 324.00 | 62,208.00    |
| MYZAFE  | QENAN   | MEHMETI    | 7 | 45/7  | 498.9  | 3560   | 1,776,084    |
| TAHIR   | ARIF    | VLADI      | 8 | 377/3 | 53.5   | 3560   | 190,460.00   |
| ATLUE   |         | YLLI       |   |       |        |        |              |
| DIANA   | BEQIR   | BIBA       |   |       |        |        |              |

|        |       |         |   |       |       |        |             |
|--------|-------|---------|---|-------|-------|--------|-------------|
| ELDA   | RAKIP | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| ELVI   | AGRON | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| ENIDA  |       | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| FATMIR |       | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| RAMAZA |       | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| RESHAT |       | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| SAIMIR | KADRI | BIBA    |   |       |       |        |             |
| EUGEN  | BILAL | BOGDANI |   |       |       |        |             |
| ELIONA | BILAL | MANUSHI |   |       |       |        |             |
| LEJLA  | HYSEN | BOGDANI | 9 | 3/282 | 36.75 | 30,783 | 1,312,75.25 |

|         |        |            |    |       |      |        |            |
|---------|--------|------------|----|-------|------|--------|------------|
| AFERDIT |        | VORPSI     |    |       |      |        |            |
| ALDA    |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| ARJETA  |        | PLESHTI    |    |       |      |        |            |
| AVENIR  |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| BARDHY  |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| FLUTURA |        | VERZIVOLLI |    |       |      |        |            |
| HALL    |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| KLEJDA  |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| LIRI    |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| LULEZIM |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| NADIRE  |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| SADETE  |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| SOKOL   |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| VERA    |        | KIKA       |    |       |      |        |            |
| VJOLLCA |        | KIKA       | 10 | 5/358 | 4.37 | 30,783 | 134,521.71 |
| VIKTOR  | MNATHO | KONOMI     | 11 | 5/116 | 0.35 | 30,783 | 10,774.05  |

|        |  |          |    |     |  |        |       |              |
|--------|--|----------|----|-----|--|--------|-------|--------------|
| BAHIR  |  | RESULI   |    |     |  | 296.00 | 5,530 | 1,636,880.00 |
| FATOS  |  | MUCO     |    |     |  | 300.00 | 5,530 | 1,659,000.00 |
| NINFA  |  | ZIU      |    |     |  |        |       |              |
| PRANVE |  | BALLHYSA | 14 | 5/1 |  | 320.00 | 5,530 | 1,769,600.00 |

|         |       |         |    |       |  |        |        |              |
|---------|-------|---------|----|-------|--|--------|--------|--------------|
| MAKSIM  |       | GEGA    |    |       |  |        |        |              |
| PERPARI | ALIM  | GEGA    |    |       |  |        |        |              |
| FATO    |       | MASKAJ  |    |       |  |        |        |              |
| MIRJETA | ALIM  | XHELAJ  |    |       |  |        |        |              |
| FJONA   | FATOS | DOLLANI |    |       |  |        |        |              |
| SILVANA | ALIM  | ALIKE   |    | 44/20 |  |        |        |              |
| ZAMIRA  | ALIM  | VELO    | 15 | 7/2   |  | 440.70 | 10,903 | 4,804,952.10 |

|         |  |           |    |       |  |        |       |              |
|---------|--|-----------|----|-------|--|--------|-------|--------------|
| FITNETE |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| AFRIM   |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| DASHAM  |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| TEFERI  |  | (CAUSHAJ) |    |       |  |        |       |              |
| MARJAN  |  | DRASA     | 16 | 28/59 |  | 500.00 | 8,300 | 4,150,000.00 |
| FITNETE |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| AFRIM   |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| DASHAM  |  | AGALLIU   |    |       |  |        |       |              |
| TEFERI  |  | (CAUSHAJ) |    |       |  |        |       |              |
| MARJAN  |  | DRASA     | 17 | 24/93 |  | 500.00 | 8,300 | 4,150,000.00 |

|        |         |         |    |       |  |        |     |           |
|--------|---------|---------|----|-------|--|--------|-----|-----------|
| LUAN   | MEHDI   | KABASHI |    |       |  |        |     |           |
| SHPRES | ANASTAS | KABASHI | 18 | 104/2 |  | 183.90 | 282 | 5,1859.80 |

|        |         |        |    |        |  |      |        |            |
|--------|---------|--------|----|--------|--|------|--------|------------|
| ALI    | XHEVDET | MIRAKU |    |        |  |      |        |            |
| ISMAIL | XHEVDET | MIRAKU |    |        |  |      |        |            |
| MEHMET | XHEVDET | MIRAKU |    |        |  |      |        |            |
| PLATON | XHEVDET | MIRAKU |    |        |  |      |        |            |
| RUKJE  | XHEVDET | MIRAKU | 19 | 1426/6 |  | 22.4 | 12,764 | 285,913.60 |

|         |          |             |    |         |  |      |        |            |
|---------|----------|-------------|----|---------|--|------|--------|------------|
| ZYRA    | XHEVDET  | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| AIDA    | FEJZULLA | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| AIDA    | URAN     | VYSHKA      |    |         |  |      |        |            |
| EMINE   | FEJZULLA | KAPERCELLI  |    |         |  |      |        |            |
| FATIME  | XHAFERR  | VYSHKA      |    |         |  |      |        |            |
| FEJZULL | URAN     | VYSHKA      |    |         |  |      |        |            |
| AGRON   | XHEVDET  | SKILJA      |    |         |  |      |        |            |
| ALI     | XHEVDET  | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| GJYSTIN | FEJZULLA | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| ISMAIL  | XHEVDET  | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| ISUF    | XHEVDET  | SKILJA      |    |         |  |      |        |            |
| MARLEN  | FEJZULLA | MIRAKU(KAL  |    |         |  |      |        |            |
| MEHMET  | XHEVDET  | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| MELEQE  | XHEVDET  | SKILJA(SHEH |    |         |  |      |        |            |
| MITHAT  | XHEVDET  | SKILJA      |    |         |  |      |        |            |
| PLATON  | XHEVDET  | MIRAKU      |    |         |  |      |        |            |
| RUKJE   | XHEVDET  | MIRAKU(TRU  |    |         |  |      |        |            |
| VJOLLCA | XHEVDET  | SKILJA(RRAB |    |         |  |      |        |            |
| ZYHRA   | XHEVDET  | MIRAKU(BAL  |    |         |  |      |        |            |
| DRITA   | FEJZULLA | VYSHKA(DAR  |    |         |  |      |        |            |
| HAJRIE  | FEJZULLA | VYSHKA(DELI | 20 | 1426/27 |  | 19.2 | 12,764 | 245,068.80 |

|        |     |         |    |     |  |        |       |              |
|--------|-----|---------|----|-----|--|--------|-------|--------------|
| NIKOLL | DOD | STERKAJ | 21 | 140 |  | 255.00 | 8,511 | 2,170,305.00 |
| NIKOLL | DOD | STERKAJ | 22 | 140 |  | 113.00 | 8,511 | 961,743.00   |





## REFORMA NE PENSIONE

### INTERVISTA

Ish-nëndrejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore: Reforma e pensioneve, si funksionon

# "Funksionimi progresiv i skemës, ja disa zgjidhje për pensionistët"

Hasan Hoxha: Sugjerimet konkrete për zgjidhjen e problematikave

Voltiza Duro

(Vijon nga numri shkuar)

**E** është folur dhe shkruar shumë për reformën në fushën e pensioneve. Është thënë dhe komentuar se reforma solli disa risi, u shoqërua me shumë avantazhe për pensionet e qytetarëve, se ajo frenon dukurinë negative në bilanci financiar të skemës. Në anën tjetër, për t'u përshatuar reformës dhe, zbatimin e saj, është folur për procedura më të lehtësuara për përfitim të pensioneve, për një fare e përmirësimi të treguesve të përgjithshëm të përfitimit si dhe, për koeficientët më të lartë të produktivitetit në këtë fushë. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Hasan Hoxha, ish zv/drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së foli për zhvillimet e fushës së pensioneve, tani pas reformës së shumëpërfolur, për përparësitë e kësaj reforme apo, për problematikën komplekse që bart për qytetarët zbatimin e saj, për më shumë hapësira dhe procedura më të lehtësuara në favor të qytetarëve, për eficiencën e ndonjë e strukture apo hallke institucionale të kësaj fushe por, dhe për atë që, së fundmi, në fjalorin e përditshëm të administrimit njihet me termin bashkëqeverisje, për të gjitha këto zhvillime dhe, për tërësinë e raporteve të kësaj natyre. Eksperti dhe një opinion me konkret për ecurinë e reformës së pensioneve dhe, për hapësira të tjera ndërhyrjeje që përmirësojnë situatën, që shmanjin disa praktika jo të rëndësishme nga pikëpamja e logjikës së ligjit, që përmirësojnë treguesit e ritit performancës në fushën e sigurimeve shoqërore apo, shtojnë zgjidhjet pozitive dhe pakësojnë kohën e humbur për qytetarët.

**Ka një perceptim, në përgjithësi, sikur fusha e pensioneve bart shumë**



Hasan Hoxha, ish-zv.drejtor i përgjithshëm i ISSH-së

**probleme e shqetësime. Sipas jush, sa qëndron një perceptim i tillë?**

Në pyetjen tuaj ka dy gjëra që duhen ndarë nga njëra tjetra. Ka probleme se pensionet janë të vogla e me diferencën të thella po themi, apo, ka vështirësi për të marrë pensionin që qytetarëve u takon sipas ligjit në fuqi? Sepse, po të jetë për të parën, këtë nuk mund ta bëjmë pjesë të kësaj interviste. Kushdo mund të thotë se: kjo është çështje e ligjit, kaq janë mundësitë ekonomike të vendit. Ndërsa, sa i përket pjesës së dytë të pyetjes, për një pjesë të qytetarëve, vërtetë ekzistojnë probleme. Ka ende shumë shqetësime nga qytetarët, pjesë e skemës ose, nga ata që përfshihen për herë të parë në skemë. Mund të themi se, një përqindje e këtij kontingjenti nuk marrin fare pension, një përqindje tjetër pensionin e marrin të cunguar, deri sa gjejnë zgjidhjen e duhur apo, përgjithnjë. Po ashtu, të pjesëm të plotë, një numër syresh, pensionin e

marrin me shumë vonë, edhe pas një viti nga momenti i lindjes të së drejtës. Ndërsa, të tjerë pasi përfundojnë proceset gjyqësore, të cilët zgjasin deri në dy apo dhe me shumë vite, sidomos për ata që "detyrohen" të kalojnë dhe në shkallë e dytë të gjykimit.

**Ju kenë qenë pjesë e drejtimit në ISSH. Si shpjegohen kaq shumë probleme për pensionistët dhe, pse barten ato pa zgjidhje nga një periudhë në tjetrën?**

Nuk është e vërteta kështu. Vitet apo periudhat nuk janë të njëjta, sa i përket problemeve që barten. Ka ndryshime, lehtësim dhe pakësim të ngarkesës negative, vihen re zhvillime progresive pozitive. Një pjesë e përmirësimeve, janë produkti i reformës të bërë katër vite më parë; kanë ardhur nga procesi i informatizimit të pensioneve dhe i dixhitalizimit të pjesëm të dokumenteve arkivore të shprehin vjetërsinë në punë dhe kontributet e qytetarëve; nga

#### STRUKTURAT

Përderisa sportelet e sigurimeve shoqërore investohen për t'u shërbyer qytetarëve, përderisa në qendër të misionit të ISSH-së, është shërbimi ndaj tyre, që qytetarët të marrin zgjidhjen e duhur ligjore, që ata të përfitojnë pa mundime të drejtën e tyre, nga ky këndvështrim, në vëmendjen e institucionit po sjell disa mundësi që, potencialisht, janë të natyrës menaxhuese që, sipas meje, nëse do të përdorëshin më mirë e me efikasitet, do të pakësonin ankesat e qytetarëve për pensionet.

ulja e peshës specifike e periudhës të para vitit 1994, në raport me periudhën e pas këtij viti; nga eksperienca e akumuluar e një pjesë të drejtuesve të niveleve të ndryshme të strukturës organizative të sigurimeve shoqërore.

Përpos këtyre që thamë, do të thosha, gjithashtu, është diskutuar e janë zhvilluar debate që, pjesa e pensioneve me probleme të



ciale, njëkohësisht dhe kryetar i Këshillit Administrativ të ISSH-së, në vitin 2016, u miratua vendimi i veçantë i qeverisë i cili, në përmbyllje, synonte procedura më të lehtësuara dhe zgjidhje më të plota në caktimin e pensioneve. Krahas këtij vendimi, u ripunuar dy rregullore të rëndësishme, u përgatitën shumë shkresa sqaruese e përgjithësuara, që lehtësuara disa procedura përmirësuan situatën, u shoqëruan me tregues të përmirësuar të performancës në strukturat e sigurimeve shoqërore. Nga përpunimi i rregullores së bazës së vlerësuar për shembull, u pakësuan rastet me qëndrime ekuivoqe apo me sjellje të dyfishtë, në caktimin e pagës referuese për disa vitet 1994. Ndërsa, nga zbatimimi i rregullores së ripunu-

jore, po themi, zgjidhjet pozitive në tërësinë e tyre, u shtuan në më shumë se 25 për qind, ose po kaq, u pakësuan pensionet me probleme. Ndërkohë që, edhe numri i qytetarëve në proceset gjyqësore pësoi një rënie mesatare pak më shumë se 1 mijë vetë në vit. Vecse, edhe pse nga kjo paketë ligjore e nënligjore e përmirësuar, që u zhvillua edhe me qëndrime të tjera unikuese dhe përgjithësuese, erdhi ky nivel i përmirësimeve në disa prej treguesve, duhet pranuar se përsëri, ajo që pritej nuk u realizua.

**Pra, edhe me këto zhvillime pozitive, përsëri për pensionet vazhdon të ketë shumë probleme. A mund të sjellësh, në mënyrë të përmblëdhur, diçka më konkrete rreth tyre?**

Është një pyetje shumë domethënëse, sepse nuk janë të pakët qytetarët do të thosha, të cilët lodhen në kërkim të së drejtës së tyre për pension. Mbase, në raport me numrin e përvitshëm të atyre që dalin çdo vit në pension, kjo pjesë mund të mos jetë më shumë se 10 për qind, duhet thënë se, pas kësaj përqindjeje, qëndrojnë për çdo vit, mesatarisht, rreth 3 mijë vetë. Me çfarë problemelesh ndeshen ata? Një pjesë syresh, përballen me ndonjë kusht ligjor të paplotësuar, i cili po themi se është "mekati" i vetë qytetarëve që, as nuk njihin ligjin, as nuk dinë të përfitojnë nga hapësirat që krijohen nga ligji dhe aktet nënligjore. Një pjesë tjetër, më e shumta, merr pension të cunguar, aspak në raport me periudhën e punës apo atë kontributive, për shkak të mungesës së

#### PROBLEMET

**H** Ka ende shumë shqetësime nga qytetarët pjesë e skemës, ose nga ata që përfshihen për herë të parë në skemë. Mund të themi se, një përqindje e këtij kontingjenti nuk marrin fare pension, një përqindje tjetër pensionin e marrin të cunguar deri sa gjejnë zgjidhjen e duhur apo përgjithnjë.

ketë një vëmendje të veçantë, për të sjellë transformime dhe, sa më shumë zgjidhje të ligjshme. Kështu, pa një opinionin të përpunuar, morën udhë disa zhvillime të pritshme pozitive. Është rasti të themi se, me iniciativën e z.Blendi Klosi, atëherë ministër i Punës dhe i Çështjeve So-

ar te Komisioneve të Ankimit, u shtuan rastet e zgjidhjeve pozitive, për shkak të shtimit të përgjegjësisë dhe të kompetencave, për shkak të zgjerimit të bazës së gjykimin apo, si rrjedhojë e sigurimit të dokumenteve shtese. Sipas disa përlogaritjeve, nga aplikimi i kësaj pakete nënlig-





← dokumenteve bazë që shprehin vjetërsinë në punë. Mungojnë regjistrat, mungojnë pjesë prej tyre, janë bërë të papërdorshëm dhe kështu, kjo situatë vazhdon të cenojë të drejtën e qytetarëve për pension në përputhje me vitet e kryera të punës. Duhet thënë se, edhe në kësi rastesh, strukturat e sigurimeve shoqërore që caktojnë pensione nuk mund të konsiderohen me përgjegjësi.

Kontingjenti tjetër i qytetarëve që sorollaten për të drejtën e tyre të pensionit, janë ata për të cilët dokumentet janë por, ato paraqiten me probleme po themi, janë me shënime të ndryshme në sistem, me ndonjë korrigjim, apo të palidhura. Në gjykimin tim, ky është grupi që nuk trajtohet me kujdesin e nevojshëm, për këtë grup mungojnë shpesh në dosje dokumentet e nevojshme për gjykim, siç

është faqja përkatëse e regjistrat apo, të borderove fotokopje. Pikërisht, për këtë grup, nisur dhe nga analiza e rasteve, kërkohet më shumë vlerësim institucional, kërkohet sjellje e përgjegjshme ligjore, kërkohet verifikim i plotë, deri në shterim, i anës dokumentare, pavarësisht mungesës së kontrolleve periodike apo, pafuqisë auditive të institucionit.

**Kemi dëgjuar se ankesat e qytetarëve për pensionet marrin zgjidhje edhe nga portali i "Bashkëqeverisjes". Si e vlerësoni ju këtë lloj zhvillimi, nëse do ta cilësonim kështu?**

Përgjithësisht, kam ndjekur ankesat, natyrën e tyre, si dhe zgjidhjet e dhëna nga portali, veçanërisht për pensionet apo, përfitimet në përgjithësi. Profesionalisht, mund të vlerësoj edhe disa zgjidhje të

**PROBLEMET**

Kontingjenti tjetër i qytetarëve që sorollaten për të drejtën e tyre të pensionit janë ata, për të cilët dokumentet janë, por paraqiten me probleme po themi, janë me shënime të ndryshme në sistem, me ndonjë korrigjim, apo të palidhura. Në gjykimin tim, ky është grupi që nuk trajtohet me kujdesin e nevojshëm, për këtë grup mungojnë shpesh në dosje dokumentet e nevojshme për gjykim, siç është faqja përkatëse e regjistrat apo, të borderove fotokopje.

dhëna por, më shumë se zgjidhjet, do t'i jepja rëndësi disa raporteve të cilët, flasin për rëndësinë që ka, sipas meje, përfitimi i zgjidhjeve brenda ISSH-së. Kështu, do të vlerësoja raportet e atyre që ankohen në portal ndaj numrit të përgjithshëm të ankesave brenda institucionit, përfshirë dhe drejtoritë rajonale; raporti i atyre që ankohen në portal me numrin e qytetarëve që i drejtohen për zgjidhje çdo vit gjykatës; rastet që zgjidhen në raport me numrin e personave që nuk marrin zgjidhje, ose marrin përgjigje negative; raporti midis zgjidhjeve të pjesshme dhe zgjidhjeve të plota; apo, raporte të tjera të cilat, kanë të bëjnë me natyrën e ankesës, së bashku me zgjidhjet për to, duke filluar me vitet e humbura të punës, nivelin e pagës, mënyra e vlerësimit, apo



Në kompleksitetin e këtij procesi, patjetër merr vlerësim përgjigjia e shpejta, ashtu sikurse, duhet thënë se, edhe zgjidhjet nga portali, krahasuar me numrin e përgjithshëm të ankesave për pensionet, janë shumë të pakta, janë krejt të papërfillshme. Të zakonshme, për të mos thënë, të rëndomta ose të rutinës, prezantohen shpesh edhe argumentet që mbështesin disa prej këtyre zgjidhjeve. Nuk është ndonjë meritë e portalit për shembull, pse për individin ankues gjenden disa vite pune në një ish-ndërmarrje apo ish-kooperativë pasi, të kësaj natyre gjetjet janë të vazhdueshme edhe jashtë portalit, ato janë pjesë e detyrës funksionale të strukturave të sigurimeve shoqërore. Në anën tjetër, portali nuk do të merrte vlerësime, nëse numri i ankesave aty, në emër të një zgjidhjeje më të

turë e tillë nuk përbën nevojë, ajo s'është gjë tjetër veçse, mbivendosje e posteve të punës apo, e funksioneve. Për gjithkënd që vlerëson këto zhvillime, efektive do të konsiderohej zgjidhja që vjen për mes kryerjes së detyrës funksionale nga hallka përkatëse apo postit i punës në organigramën e institucionit. Sepse, këtij vendi i intereson fuqizimi ligjor se brendshmi i institucioneve, i intereson zbatimi i sakte i rregulloreve, që përcaktojnë procedura dhe afate për plotësimin e kërkesave të qytetarëve. Ndryshe nga portali, është institucioni ai që, me strukturën dhe pozicionet e tij të punës, transmeton shkallën e zbatimit të ligjit, që përdor eksperiencën e akumuluar apo, kontribuon për ndryshime dhe përmirësime të paketës legjislative.

**Keni sugjerime konkrete për strukturat institucionale që numri i ankesave për pensionet të jetë më i pakët?**

Po, ka shumë mundësi, janë disa aspekte të paezuaruara në këtë fushë. Sepse, vërehen disa paradokse që nuk janë të ligjit, por të zbatimit të tij, nuk janë të paketës ligjore, por të asaj nënligjore, nuk janë të pushtetit legjislativ, por të atij ekzekutiv, ndonjëherë nuk janë as të qeverisë por, do t'i vlerësoja si probleme të strukturave të Sigurimeve Shoqërore. Dhe, përderisa sportelet e sigurimeve shoqërore investohen për t'u shërbyer qytetarëve, përderisa në qendër të misionit të ISSH-së, është shërbimi ndaj tyre, që qytetarët të marrin zgjidhjen e duhur ligjore, që ata të përfitojnë pa mundime të drejtën e tyre, nga ky këndvështrim, në vëmendjen e institucionit po sjell disa mundësi që, potencialisht, janë të natyrës menaxhuese që, sipas meje, nëse do të përdoretshin më mirë e me efikasitet, do të pakësonin ankesat e qytetarëve për pensionet. Me konkretisht:

Më shumë vendime në favor të qytetarëve, mund të jepen nga Komisionet e Ankimit, në rastet kur në

vërtetimet e vjetërsisë së tyre të punës sidomos, në ish-kooperativë, vërehen shënime arkivore të papërgjegjshme, shpesh edhe të pakuptimta sidomos, për të dhënat e natyrës identifikuese. Një përfundim i tillë mbështetet thjesht edhe nga fakti se, qytetarët që kanë shkuar në gjykatë për këto shkaqe, vendimet i kanë pothuajse të gjitha pozitive.

Është krejt e panevojshme, përfshirja e qytetarëve në procesin e ankimit brenda strukturave të sigurimeve shoqërore, kur dokumentet e vjetërsisë në punë nuk ekzistojnë. Qysh në nisje, qytetarët të pajisen me përgjigjen institucionale negative, për t'i hapur rrugë ankësës në gjykatë për vitet e munguara të punës. Kështu, do të mënjanohej ajo pjesë e kohës të cilën, qytetarët vazhdojnë të humbin, pa asnjë lloj rezultati pozitiv, brenda strukturave të sigurimeve shoqërore.

Nuk duhet të ndodhë apelimi për vjetërsi pune i vendimeve gjyqësore që qytetarët sigurojnë nga shkalla e parë e gjykimin, qofshin ato vërtetime të faktit juridik apo, për (pa)vërtetësi të dokumenteve. Fakti që, pothuajse 100 për qind e vendimeve të apeluara, kanë patur të njëjtin përfundim si në shkallën e parë, tregon se apelimet për këto çështje nuk kanë asnjë vlerë për institucionin.

Disa prej këtyre momenteve që theksova, gjenden dhe në vendimin e posaçëm të Këshillit të Ministrave të vitit 2016. Pas një procesi auditues, analiza tërësore që mund t'i bëhet zbatimit të këtyre profileve, jo pak të përhapura sa i përket marrëdhënies me pensionistët ose, do të sjellë nevojën e mbështetjes me vendime të shkruara të strukturave drejtuese të Institucionit ose, me gjasë, do të provojë mosreputimin e tyre nga disa prej komisioneve apo, juristëve të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.

**PENSIONET**

Është diskutuar e janë zhvilluar debate që pjesa e pensioneve me probleme të ketë një vëmendje të veçantë për të sjellë transformime dhe sa më shumë zgjidhje të ligjshme.

koha e fillimit të pagesës së pensionit.

shpejtë e më të sigurt, do të ishte në disa qindra apo, nëse ky numër, akoma më tej, do ishte rreth 3 mijë vetë në vit, aq sa është numri i përgjithshëm i atyre që ankohen. Atëherë, kjo do të ishte shqetësuese, do të përthehej si anashkalim i institucionit ose, me mosfunksionimin e tij që, është ligjërisht i ngarkuar për zgjidhje.

Ndërkaq, ankesat drejt portalit, të shumta e ne vijmësi, do të ishin një kamber alarmi, pasi në këtë rast, në raport me institucionin e pensioneve, kjo strukturë është e përkohshme, përbën veçori apo, është një gjetje e kryeministrit. Sigurisht, në një qeveri tjetër, me një tjetër kryeministër, kjo strukturë e sotme apo, ky mjet pune po themi, nuk do të jetë kështu. Sipas meje, një strukturë



Foto ilustruese

Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka lajmëruar disa ndryshime në marrjen e targave të veçanta. Sa i përket ndarjes së targave të veçanta për automjetet është: Kategoria A, të cilës i përkon tarifa prej 30,000 lekë dhe përmban targat si 001, 007 dhe tre numrat e njëjtë 111, 222,.....999. Sipas të dhënave nga Drej-



## Targat e veçanta për automjetet

### DPSHTRR: Ja sa janë tarifat e reja për secilën kategori

toria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, mësohet se kategoria B që i përkon tarifa 20,000 lekë dhe përmban targat që fillojnë me dy zero përveç 001 dhe 007.

Pra nga 002, 003,.....009. Po ashtu targat që mbarojnë me dy zero 100, 200,.....900 dhe targat me dy numrat anësor njësoj, pra që kanë zero në mes 101, 202,.....909. Drejtoria

Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën të ditur se në të dyja rastet plus tarifën bazë të regjistrimit të mjetit. Sipas njoftimit, zgjedhja e targave bëhet vetëm 'on-

line' në website: www.dpshttrr.gov.al. Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton se aplikuesi zgjedh 'live' nga inventari i serive të prodhuara nga DPSHTRR. Fondi i targave furnizohet periodikisht dhe informacioni publikohet pikërisht për këtë. Paguesa kryhet në sportel në momentin e regjistrimit të mjetit në afate të caktuara.

Banka e Shqipërisë: Optimizmi u rrit me 4.6 pikë gjatë 3-mujorit të parë vitit 2019

# BSH: Gjendja financiare dhe punësimi shënuan rritje

Bumi i ndërtimeve shton besimin në ekonomi


Sektori i ndërtimit, si në objekte të reja, ashtu edhe në kontratat e porosisë e ka rritur indeksin e besimit në ekonomi në tremujorin e parë 2019, edhe pse degët e tjera të ekonomisë mbeten dobët. Edhe balancat e tjera të vërtetimit si: gjendja financiare, punësimi dhe pritjet për të në ardhmen shënuan rritje në tremujorin e parë. Këtë dinamike ndoqi edhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve, e cila u rrit si në terma tremujorë me 3.6 pikë përqindje, ashtu edhe në terma vjetorë me 4.0 pikë përqindje. Kjo normë e shfrytëzimit të kapaciteteve rreth 66.4% qëndron 2.7 pikë përqindje mbi mesataren historike të treguesit. Të dhënat u bënë të ditura dje nga Banka e Shqipërisë. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) u rrit me 4.6 pikë gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, duke shënuar vlerën 106.5.

#### NDËRTIMI

Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) u rrit me 8.0 pikë përqindje gjatë tremujorit të parë, duke u zhvendosur mbi mesataren historike të tij. Dinamika e TBN-së u ndikua nga rritja e të dy balancave përbërëse të treguesit, aktivitetit ndërtues me 9.3 pikë përqindje dhe kontratave porosisë me 6.7 pikë përqindje. Edhe balancat e tjera të vërtetimit si: gjendja financiare, punësimi dhe pritjet për të në ardhmen shënuan rritje në tremujorin e parë. Këtë dinamike ndoqi edhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve, e cila u rrit si në terma tremujorë me 3.6 pikë përqindje.

#### SHËRBIMET

Treguesi i besimit në sektorin e shërbimeve (TBSH) shënoi një rritje të lehtë me 0.3 pikë përqindje në tremujorin e parë, duke ndërprerë dinamikën rënëse të ndjekur prej një viti. Treguesi qëndron 4.3 pikë përqindje mbi mesataren historike të tij. Përmirësimi i TBSH-së i atribuohet vetëm njërit prej komponentëve të tij formues, balancës së kërkesës, të përmirësuar me 1.0 pikë përqindje. Ndërkohë, balanca e tjetër përbërëse e TBSH-së, ecuria e biznesit, shënoi rënie me 0.4 pikë përqindje.



Burimi: Vërtetimi i Besimit të Biznesit dhe Vërtetimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## Sistemi bankar, Sejko: Karakterizohet nga nivele të mira likuiditeti

Aktualisht sistemi bankar karakterizohet nga nivele të mira likuiditeti, kapitali dhe përfitueshmëria, të cilat mundësojnë premisa pozitive për rritjen e kreditimit në vend". Këtë e ka bërë të ditur kreu i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë takimit me delegacionin e Bankës Botërore, të kryesuar nga Maryam Salim, përfaqësuese e përhershme e Zyrës së Bankës Botërore në vendin tonë. Sipas Sejkos, sistemi bankar është në një fazë të rëndësishme konsolidimi, që pritet të kontribuojë në rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij. Ndërkohë, ndërsa është ndaluar të kreditit me probleme, sipas Sejkos,



Kreu i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë takimit me delegacionin e Bankës Botërore

plani ndërinstucional i vepimit për reduktimin e tyre ka dhënë efektet pozitive. Në vijim, guvernatori njohu delegacionin edhe me punën e realizuar nga Banka e Shqipërisë për hartimin e projektligjit "Për shërbimet e pagesave", i cili synon të përfillojë një direktivë të rëndësishme evropiane në fushën

e pagesave. Ky projektligj, i cili do të kalojë për miratim së shpejti, pritet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në ndikjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin dhe reduktimin e kostove që mbart përdorimi i tyre.

#### TREGTIA ME RËNIE

Treguesi i besimit në sektorin e tregtisë (TBT) ndërpreu prirjen rënëse të tremujorëve të mëparshëm, duke u rritur me 4.0 pikë përqindje gjatë tremujorit në analizë. Megjithatë, treguesi mbetet nën mesataren historike.

Dinamika rënëse shfaqën edhe balancat e tjera të vërtetimit si: pritjet për kërkesën në tremujorin e ardhshëm, punësimi, pritjet për të në tremujorin e ardhshëm dhe gjendja financiare. Për sa i takon normës së shfrytëzimit të kapac-

#### Taksimi po rrit varfërinë

## BB: Ndhimja sociale e shtetit shqiptar, e pamjaftueshme

Taksimi në vendet e Ballkanit Perëndimor nuk ka rol rishpërndarës, thotë Banka Botërore në raportin më të fundit për rajonin. Për të ilustruar këtë, institucioni me bazë në Uashington jep pikërisht shembullin e Shqipërisë. Taksimi i drejtpërdrejtë në vendin tonë, pra taksat që paguhen direkt, si dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale vlerësohet se kanë ndikim të papërfillshëm në uljen e pa pabarazisë. Këtë e tregon mjaft mirë koeficienti GINI, thotë Banka Botërore. Por, nga ana tjetër, kur flet për politikën fiskale në tërësi, situata ndryshon. "Politika fiskale në tërësi, veçanërisht Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, ka një efekt të vogël në rritjen e varfërisë", thotë Banka Botërore në raport. Ky efekt i politikave fiskale të qeverisë nuk është në gjendje që të zbëzhet nga ndihma sociale. Kjo e fundit e ka të pamundur që të balancojë efektin që taksat e larta kanë në shtresën më vulnerabile të popullsisë, pra ata më të varfrit. Banka Botërore thotë gjithashtu se progresiviteti i sistemit të taksimit në vendin tonë është i ulët dhe kjo ndikon në rritjen e varfërisë, si dhe mosluftimin e papabarazisë. Ekonomia shqiptare ka vuajtur gjithmonë faktin se normat e larta të rritjes ekonomike nuk reflektohen në mirënjehje për qytetarët. Politikat fiskale janë përgjegjëset kryesore të paaftësisë për të shpërndarë si duhet pasurinë.

## INSTAT, inflacioni 1.1% për marsin, niveli më i ulët në 3 vjet

Inflacioni pësoi një rënie të fortë dhe të papritur në muajin mars. Sipas Institutit të Statistikave, norma vjetore e inflacionit zbriti në 1.1%, nga 1.7% që kishte qenë për muajin shkurt. Ky është niveli më i ulët mujor i inflacionit, i regjistruar që në mesin e vitit 2016. Rënia e inflacionit i detyrohet sidomos grupit të ushqimeve. Inflacioni i këtij grupi ra në 2% për marsin, nga 3.8% që kishte qenë për muajin shkurt. Më në detaj, ato që ndikuan më shumë në zbutjen e inflacionit ishin çmimet e nëngrupit "fruta", që u ulën me 7.8%, pasuar nga nëngrupet "vajra dhe yndyrna" me 0.7%, "bukë dhe drithëra" me 0.6%. Grupet e tjera regjistruan luhajtje të vogla dhe ndikimi i tyre në ndryshimin e inflacionit për shkurtin ishte modest. Shifrat e muajit mars tregojnë se rritja graduale e inflacionit drejt objektivit prej 3% mund të ngadalësohet. Në fakt, Banka e Shqipërisë kishte parashikuar që mbicimit i lëkund do të vazhonte të jepte efekte në uljen e çmimeve edhe në gjysmën e parë të këtij viti. Por, rënia e inflacionit në mars duket se shkon përtej pritshmërive të lidhura me efektin e kursit të këmbimit.



Kryeministri Edi Rama takon studentët praktikantë dhe pedagogët

# Rama risulmon rektorin e UT-së: Universiteti s'është për tendera

## Ministrja e Arsimit: 2000 pozicione pune për praktikën

**K**ryeministri Edi Rama ka shigjetuar sërish rektorin e Universitetit të Tiranës, Mynyr Konin, ndërsa e fajësoi atë si përgjegjës kryesor për mungesën e aksesit të studentëve në "Bibliotekën Online". Ai tha se universiteti nuk mund të përdoret për të krijuar tenderë, por për t'iu shërbyer nevojave imediate, që kanë të gjithë studentët në Universitetin e Tiranës. Shefi i qeverisë u ndal edhe te vlerësimi i titujve akademikë, ku sipas tij, shumë pedagogë kanë tituj pa asnjë vlerë dhe universiteti nuk ka bërë asnjë hap për cilësimin e tyre. "Ky është kulmi, që të sigurohet biblioteka dixhitale për studentët dhe që UT mos ta përdori dot se nuk ka sistem teknologjik, që lejon përdorimin e bibliotekës dhe studentët të jenë të përjashtuar nga aksesit për shkak se rektori dhe rektorati, të cilët kanë përgjegjësi. Ky është kulmi. Unë nuk e di se çfarë duhet të ndodhë më tepër. Të gjithë punët e studentëve të mbahen me kopje në dorë sikur të jemi në kooperativën bujqësore dhe më e rënda është se në vend që t'i zgjidhi, rektori ankohet. Ankohet se pse unë e sjell këtë temë në diskutim, por si t'ia bëjmë? Ta mbajmë këtë përgjegjësi edhe ne. Universiteti është autonom, po nuk është theksit liri për të bërë tenderë apo e drejtë për të bllokuar universitetin për tenderë, por është përgjegjësi. Duhet një zgjidhje, ndërsa ne kemi propozuar që mos të ndërhyjmë, por realisht është problem. Kur thosha se unë do të mbeset protestues i fundit, ju atëherë qeshnit dhe më thoshit: Shko njëherë plotësisht 8 pikat. Vlerësimin e titujve akademikë e bën universiteti. Asnjë hap, zero, pse? Sepse ajo do të hapë një proces njësoj si ai i gjykatësve dhe prokurorëve dhe ka shumë nga ata që janë profesor që u shfaqen si pedagogë, por, në fakt, janë sharlatanë dhe titujt i kanë pa asnjë lloj vlerë dhe asnjë lloj baze. Unë bënë doktorët e shkencave sikur të jenë shalqinj. Do durojmë e do durojmë, por edhe ne do të plasim në fund"-tha Rama sot në një bashkëbisedim me studentët, të cilëve iu është krijuar tani mundësia për të ushtruar praktikë rreth profesionit të tyre.



Kryeministri, Edi Rama

Rama tha se universiteti nuk mund të përdoret për të krijuar tendera, por për t'iu shërbyer nevojave imediate, që kanë të gjithë studentët në Universitetin e Tiranës. Shefi i qeverisë u ndal edhe te vlerësimi i titujve akademikë, ku sipas tij, shumë pedagogë kanë tituj pa asnjë vlerë dhe universiteti nuk ka bërë asnjë hap për cilësimin e tyre.

gramit kombëtar të praktikave të punës", ku mori pjesë dhe kryeministri Edi Rama, ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) znj. Besa Shahini, dhe nja panoramë të përgjithshme të këtij programi duke e cilësuar këtë vit si më të mirin në krahasim me vitet e tjera: "Është viti i dytë që koordinimin e programit e bën MASR. Zhvillimi profesional i të rinjve është prioritet i yni dhe po përpikim vazhdimisht që të gjejmë forma të reja për të zgjeruar gamën dhe numrin e praktikave të punës. Janë rreth 2000 studentë në total, të cilët kanë realizuar praktikën 3-mu-

jore përgjatë viteve 2015, 2016 dhe 2018. Ndërsa sivjet, në kuadër të "Paktit për Universitetin", kemi arritur të koordinojmë mbi 2000 pozicione të lira për praktikën e punës, duke thyer rekordin e pozicioneve praktike". Ajo shtoi, gjithashtu: "Kryesisht praktikantët e punës i kemi siguruar nëpër institucione publike, në nivel qendror e lokal, dhe një numër më i vogël pranë kompanive private. Kjo është një sfidë që na mbetet ta adresojmë, në mënyrë që të rrisim interesimin e kompanive private për praktikantët e rinj".

Ministrja Shahini, duke theksuar faktin se është një ndër objektivat kryesorë të MASR për të lehtësuar e mbështetur në mënyrë të vazhdueshme kalimin nga arsimit në tregun e punës, u shpreh se ky program kombëtar mishëron më së miri vlerat dhe arritjen e këtij objektivit. "Gjatë këtij programi, do të realizohen detyra dhe angazhime të institucionet përkatëse bazuar në një plan pune 3-mujor dhe drejtuar nga një mbikëqyrës. Pas përfundimit me sukses të programit, praktikantët do të pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje. Pas prak-

### Veliaj: S'ka vend për kundërshtarët e shkollave

## Universiteti Bujqësor: Jo mësim po s'u anulua ndërtimi i shkollës

Pas disa ditësh protestë për të penguar ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në fidashten e Universitetit Bujqësor të Tiranës, është mbledhur Asambleja e Pedagogëve që ka vendosur për përshkallëzim të protestës. Asambleja e Pedagogëve ka vendosur, gjithashtu, për bojkot të mësimin, duke e konsideruar këtë protestë jo të studentëve, por të pedagogëve dhe gjithë universitetit. "Pedagogët do të udhëheqin studentët në grevë. Nuk është protestë e studentëve, por është e pedagogëve dhe e gjithë universitetit. Nuk është e logjishme të ndërtohet shkollë 9-vjeçare pranë universitetit. Do vijojmë me grevë derisa të tërhiqet bashkia nga ky vendim. Ka të tjera hapësira për shkolla, por i duan ato toka për pallate", shprehet një pedagog i UBT për "News24". Projekti i Bashkisë së Tiranës, i cili parashikon ndërtimin e një shkollë të integruar, nëntëvjeçare dhe të mesme pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës ka shkaktuar reagime të forta dhe rezistencë tek pedagogët dhe studentët. Nga ana tjetër, këtë projekt e ka kundërshtuar me forcë edhe Partia Demokratike. Ditën e djeshme nga Kavaja, kryedemokrati Basha tha se prishja e fidashtes tek korpusi i UBT-së është një lojë e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Sipas tij, pas kësaj fshihet ndërtimi i një lagjeje me pallate 10 katëshe, të cilat do t'u jepen më pas oligarkëve të kreu të



### VENDIMI

Asambleja e Pedagogëve ka vendosur, gjithashtu, për bojkot të mësimin, duke e konsideruar këtë protestë jo të studentëve, por të pedagogëve dhe të gjithë universitetit. "Pedagogët do të udhëheqin studentët në grevë. Nuk është protestë e studentëve, por është e pedagogëve dhe të gjithë universitetit."

### bashkisë.

### KRYEBASHKIAKU

Erion Veliaj tha se Bashkia e Tiranës është e vendosur që t'i shkojë deri në fund realizimit të projektit të 17 shkollave, pavarësisht zhurmës që krijohet nga një pakicë që shprehet kundër qytetit që sjell zhvillim në qytet. "Jam më i vendosur se kurrë që të vijojmë me projektin e 17 shkollave. Dua t'i kujtoj veliajt që ngrihet kundër shkollës shqipe, se historia e Shqipërisë ka një vend shumë të errët për ata që ngrenë dorë kundër shkollës shqipe", theksoi Veliaj. Duke iu referuar pikërisht protestave kundër projektit të shkollës së re të integruar në Kodër-Kamzë, Veliaj theksoi se ajo do t'i shërbejë 30 mijë banorëve që

sot janë të detyruar t'i çojnë fëmijët e tyre shumë larg nga zona e tyre e banimit. "Kodër-Kamza sot ka rreth 30 mijë banorë. Kemi dy mundësi: ose ta shohim Kodër-Kamzën si kontingjent për protestë dhe dhunë, siç bëjnë disa parti për interes të tyre apo të politikanëve që fëmijët e tyre i çojnë në shkolla jashtë shtetit, ose të themi se ka ardhur koha që edhe ai komunitet të ketë një shkollë cilësore, po aq cilësore sa shkolla "Kosova", që djemtë dhe vajzat aty të mos jenë kontingjent dhune, por kontingjent talenti, pasioni dhe pune, që vjen vetëm nëpërmjet djersës së tyre", shtoi Veliaj.

tikës 3-mujore, 200 praktikantët më të mirë do të pësohen me kontratë 1-vjeçare pune në të njëjtën formë sikurse studentët

ekselentë u punësuan në administratën shtetërore nëpërmjet portalit www.punetembare.al. Deri më sot, mbi 460 studentët

ekselentë janë punësuar në administratë - rreth 300 prej tyre me diplomë "Master" dhe 160 me diplomë "Bachelor", vijoi ministrja.

**Njoftim për shitje me ankand të parë**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 28.03.2019 ankandin e parë të pasurisë të palës debitore SH "Meat Master Vilezerit Kimca" sh.p.k dhe e palës dorëzuese, e përbërë nga:

"Njesi" me numër pasurie 780 ND e ndodhur në Rr: "M Bicikim" Shkodër e rregjistruar në ZK 8593 Regj Hipotekor nr.83 datë 30.10.1988 volum 17, faqe 149 me sipërfaqe 42.75 m<sup>2</sup>. Ankandi i pasurisë fillon me gminim fillestar në masën 45.517.3 Euro dyzote e pesemije e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë të Euro.)

Ankandi do të zhvillohet në datë 15.04.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir\_dervishaj@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com.

**Shoqëria përbarimore JUSTITIA**

Shoqëria përbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së palauajshme për të cilën ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:

Apartamenti me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sipërfaqe m<sup>2</sup>, Rruga "Zenei Baboçi" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujtim TOSKJU.

Në vlerën 124.006 Euro ( njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur ).

Ankandi zhvillohet në datën 23.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, nga 16:30 në zyrën e përbarimeve gjyqësore me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

**MINISTRJA E ARSIMIT**  
Në ceremoninë e "Pro-



Bashkëshortët Gazmend dhe Gentjana Musta

## Ekzekutoi gruan dhe kumatën, gjykata u refuzon prindërve të autorit kujdestarinë e dy fëmijëve

**FIER** - Gjykata e Fierit ka zgjidhur përfundimisht çështjen e kujdestarisë për dy fëmijët e Gazmend Mustës, i cili në fillim të janarit të 2019 ekzekutoi me armë gruan dhe kumatën e tij 18-vjeçare brenda shtëpisë. Kujdestarinë për fëmijët e Gazmendit e ka fituar daja dhe jo gjyshërit e fëmijëve. Gazmend Musta vrau më 2

janar gruan e tij, Gentjana Musta, pasi kjo e fundit kërkoi të shkonte për një vizitë tek prindërit e saj për festën e Vitit të Ri. "Pranimin e kërkesës së kërkuesit/paditësit Gjyshmir Çaushaj. Vendosi në kujdestari të të miturve Jonida Musta, e bija e Gazmend dhe Gentjana dtl. 17.01.2009 dhe Florian Musta, i biri i

Gazmend dhe Gentjana, datëlindja 24.11.2015. Caktimin si kujdestar ligjor të tyre shtetasin Gjyshmir Çaushaj, daja i fëmijëve të mitur. Rrëzimin e kërkesës së palëve kërkuese Bedri Musta dhe Lumturi Musta. Të regjistrohesh vendosja e kujdestarisë në regjistrin e kujdestarisë që ndodhet pranë Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Fier. Një kopje e këtij vendimi brenda 10 ditëve nga marrja e formës së prerë të vendimit, t'i njoftohet Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Ballsh, për të bërë shënimet përkatëse. Shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të palëve kërkuese. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Vlorë, afat ky që fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar", thuhet në vendimin e Gjykatës së Fierit.

Banorët: S'e gëzuan shtëpinë që ua ndërtoi kisha. Bashkia: Do e ngremë banesën për 40 ditë

**PUKË**

**N**jë shtëpi është shkumbuar nga flakët e zjarrit, duke i marrë jetën çiftit të bashkëshortëve Petrit dhe Dava Ndoj 40 dhe 35 vjeç. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në lagjen "Va Shënkoll" të fshatit Breg. Banesa u përfshi nga flakët rreth orës 02:00 të mëngjesit të djeshëm. Mësohet se bashkëshortët po flinin në katin e dytë të banesës kur ka rënë zjarri. Ndërsa kanë pësuar dëmtime të lehta edhe katër fëmijët e tyre, të cilët janë hedhur nga dritarja e katit të dytë. Fëmijët (më i madhi 12 vjeç) kanë arritur të shpëtojnë mrekullisht nga flakët gjyshen e moshuar, e cila ishte e paralizuar dhe nuk kishte mundësi të ecte. Pas ngjarjes, katër fëmijët morën mjekim të shpejtë dhe më pas janë strehuar tek të afërmit e nënës. Burimet nga policia lokale bënë të ditur se alarmin për zjarrin e ka dhënë i zoti shtëpisë, Pal Gjoni, i cili kishte dëgjuar zhurmën e tregulave. 82-vjeçari me bashkëshorten e paralizuar po flinin po ashtu në katin e dytë të banesës, ndërsa fatmirësisht kanë arritur të dalin pa dëmtime. Trupat e pajetë të Petrit dhe Dava Ndoj u gjetën pranë njëri-tjetrit teksa kishin tentuar të dilnin nga dhoma. Porcat zjarrfikëse të Pukës dhe Fushë-Arrëzët kërkuuan rreth dy orë për gjetjen e trupave nën mbetjet e zjarrit. Ndërkaq, policia dhe grupi hetimor ndodhen në vendngjarje dhe po punojnë intensivisht për zbardhjen e rrethanave.

**DËSHMIA E KRYEFAMILJARIT**

Mëngjesi i djeshëm ishte i kobshëm për familjen me tetë anëtarë nga fshati Breg i Pukës. Banesa e tyre u përfshi nga zjarri dhe për pasojë humbën jetën çifti i bashkëshortëve, Petrit e Dava Ndoj, përkatësisht 40 dhe 35 vjeç. Ata flinin në katin e dytë të shtëpisë kur zjarri u mori jetën, ndërsa 4 fëmijët dhe gjyshërit arritën të dilnin shëndoshë e mirë nga banesa. Familja kishte vetëm pak kohë që banonte në shtëpinë e re të ndërtuar nga kisha katolike, por fati nuk dëshoi që ta gëzonin për shumë kohë. Pas ngjarjes së rëndë, i zoti i shtëpisë, Pal Gjoni ka treguar për "Gazeta Shqiptare" tmerrin që ka parë

# Tragjedi në Pukë, shtëpia shkumbohet nga zjarri, humbin jetën burrë e grua

*U mbijetojnë flakëve 4 fëmijët e 2 pleqtë. 82-vjeçari: U tmerruam, ajo që më ndodhi mua, mos i ndodhtë askujt*



I mbijetuari, Pal Gjoni duke folur për "Gazeta Shqiptare"

me sytë e tij. Ai u shpreh se ka thirrur djalin për të shpëtuar gruan e paralizuar, por kjo thirrje nuk u dëgjua asnjëherë, pasi ai së bashku me bashkëshorten ndërruan jetë duke lënë pas katër fëmijë jetimë. "Kam dëgjuar tregullat që kërcisnin kur më doli gjumi. Jam zgjuar shpejt, kisha hallin e fëmijëve. I kam thirrur djalin që të nxirrte gruan që e kam të paralizuar. Ai nuk mu përgjigj kurrë më. U gëzova kur pashë që fëmijët ishin në oborr. Ajo që më ndodhi mua, mos i ndodhtë askujt", tha i moshuari. Burimet e mësipërme pohuan se çifti i të moshuarve është strehuar në një shtëpi tek të afërmit në fshat, ndërsa katër fëmijët pas mjekimit janë dërguar tek të afërmit e nënës së tyre. Ende nuk dihen shkaqet e zjarrit. Grupi hetimor dhe policia në vendin e ngjarjes punojnë për dokumentimin e plote të saj. Paraprakisht dyshohet se zjarri është shkaktuar nga një shkëndijë elektrike.

**BANORËT**

Ngjarja e rëndë në famil-

jen Ndoj ka tronditur banorët e zonës. Sapo kanë parë flakët dhe shtëllungat e zeza të tymit, bashkëfshatarët kanë shkuar menjëherë në vendngjarje për të shpëtuar ç'të mundnin. Ndërkaq, kryebashkiaku tha dje se ka parë një tronditje të madhe në radhët e banorëve. "Deshi Zoti dhe fati që një pjesë e familjes së tyre doli pa problematika. Ne bëmë një veprim jashtëzakonisht të mirë në kohë dhe afat të caktuar, por koha për t'i



Zjarrfikësit në vendin e ngjarjes

minimizuar këto fatkeqësi ishte shumë e shkurtër. Isha prezent kur u bë nxjerrja e trupave, ndje një tronditje të rëndë psikologjike kur pash të bashkëqytetarët e mi një dramë të madhe, do të mbeten në kujtesën time...", tha kryetari i Bashkisë së Pukës pas tragjedisë. Tashmë të shpëtuarit ndodhen në banesën e të afërmit të tyre, xhaxhait. Bashkia dhe një biznesmen kanë marrë përsipër të ndërtojnë shtëpinë e shkumbuar. Do

të jetë gati për 40 ditë tha kryebashkiaku Gjoni. "Mblodhëm Shtabin e Emergjencave, ku vendosëm që familjes në bashkëpunim me donatorë, t'i japim ndihmesë, funeralin, për t'i bërë shtëpinë për 40 ditë. E falënderoj atë biznesmen që mori përsipër realizimin e kësaj detyre. Aty ku ka unitet, marrja e situatës në dorë në kohën e duhur, nxitet edhe opinioni në ndjesinë njerëzore, që shpesh na ka humbur", - tha Gjoni.



## Pako e dyshimtë pranë zyrës ligjore, alarmohen qytetarët

**VLORE** - Pasditen e djeshme është gjetur një pako e dyshimtë eksploziv pranë një zyre avokatie në Vlorë. Mësohet se pakaja e dyshimtë është pikasur pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë. Menjëherë policia dhe Forcat Xheniere janë nisur drejt vendit, ku dyshohet se ndodhet sasia e lëndës plasëse. "Sot rreth orës 14:14, në lagjen Hajro Çakërrri në Vlorë, në derën e një zyre ligjore është gjetur një objekt, ku brenda tij dyshohet të ketë lëndë plasëse. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

**Maskat vjedhin me armë shtëpinë e biznesmenit**

**FUSHË-KRUJË** - Disa persona të armatosur dhe të maskuar kanë vjedhur paraditen e djeshme një banesë në Fushë-Krujë. Mësohet se autorët kanë vjedhur një sasi parash në banesën e shtetasit Isuf Cela. Ky i fundit ka një biznes të rregullimit të pajisjeve elektroshtëpiake. Kjo ngjarje ka ndodhur në lagjen "Punëtori", ndërsa nuk dihet ende sasia e parave të vjedhura. "Sot rreth orës 12:00, në lagjen 'Punëtori', në Fushë-Krujë disa persona ende të paidentifikuar, dyshohet njëri prej tyre me armë, kanë hyrë në banesën e një shtetasi dhe kanë grabitur një sasi lekësh. Në vendngjarje është grupi hetimor, i cili po punon për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve", njoftoi policia.



Çfarë mendon Majlinda Bregu për "dhëndrin"?

# Një 'love story' në horizont! Zbulohet vajza që i ka rrëmbyer zemrën Erik Fullanit

Ja detajet e lidhjes së shumëpërfolur

Egla Xhemali

**N**uk ka qenë pak herë në qendër të vëmendjes së mediave rozë dhe portaleve. Erik Fullani është përfolur për lidhje të shumta me vajza të njohura dhe jo vetëm. Pas humbjes drastike të peshës, miqësisë me Noizyn, faktin se ishte i biri i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, ndikuan që t'i shtoheshin shumë femrat në jetën e tij. Jeta e luksit, pushimet në vendet ekzotike, makinat e shtrenjta, fakti se e fshinte djersën me 500 eurosh, i dhanë një vëmendje të madhe mediatike. Në dukje shumë spontan, Eriku nuk heq dorë as nga jeta e luksit dhe, as nga vajzat e bukura.

Së fundmi, ai ka nisur një marrëdhënie me vajzën e ish-deputetes së PD-së, Majlinda Bregu.

Kejda Ajazi është 20-vjeçarja, që shijon lekët e mamit dhe babit dhe, siç



duket, i ka rrëmbyer zemrën djaloshit simpatik. Pak kohë më parë, Erik Fullani ishte në lidhje me një bionde simpatike, po 20-vjeçare, të quajtur Mari Vasili. Më poshtë "Pamfletit" ka mundësuar profilin e

saj në "Instagram", të cilin e mban privat. Vajzën bionde e la për Kejden. Lidhjen nuk e kanë bërë ende publike për mediat duke zgjedhur ta jetojnë në intimitet të plotë romancën. Janë kapur shumë herë



mat dhe burimet pranë çiftit e kanë konfirmuar marrëdhënien e tyre. Ata pushimet i kalojnë bashkë, jashtë vendit për t'i shpëtuar syrit të paparacëve. Gjithashtu, marrëdhëniet mes familjarëve janë të

mira dhe ish-deputetja Majlinda Bregu, e konsideron si partner të denjë Eriku për të bijën. Fotot në vendet e njëjta, faktit se Eriku është tërhequr shumë nga jeta e natës dhe daljet me femra të ndryshme, na e

konfirmojnë lajmin e lidhjes. Deri më tani nuk është pohuar dhe as mohuar ky lajm që ka bërë mjaft bujë, megjithatë ne urojmë që të rinjtë të jenë të lumtur kraher njëri-tjetrit.



Votimi në veri, Ramush Haradinaj: Dilni dhe votoni masivisht

Presidenti Thaçi shpall zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat veriore

Ditën e djeshme, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shpalli datën e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës.



RAMUSH HARADINAJ

"Ftoj subjektet politike të cilat garojnë në zgjedhjet e 19 majit 2019 ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, duke marrë pjesë në këto zgjedhje.

iq, i Zvečanit, Vuçina Jankoviq, i Leposaviçit, Zoran Todiq, dhe i Mitrovicës Veriore, Goran Rakić, kanë thënë se me këtë taksë, "serbëve të Kosovës u është kërcënuar e drejta për jetesë, shërim dhe mbi-

jetesë". Qeveria e Kosovës, pavarësisht thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar për heqjen e taksës, ka thënë se ajo do të mbetet në fuqi deri kur Serbia të njohë pavarësinë e Kosovës. Nga ana tjetër, kryeministri i

Kosovës Ramush Haradinaj përmes një statusi në profilin e tij në "Facebook" ka shprehur qëndrimin e tij pas shpalljes të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri të vendit. Haradinaj tha se partitë poli-

tikë në veri duhet të hyjnë në zgjedhje, ndërsa shtoi se qytetarët duhet të dalin masivisht në zgjedhje. Statusi i Haradinaj: Pas vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, për shpalljen e zgjedhjeve në Komunat e Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan, Leposaviq, dhe Mitrovicë e Veriut, ftoj subjektet politike të cilat garojnë në zgjedhjet e 19 majit 2019, ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, duke marrë pjesë në këto zgjedhje.

SHKURT

Pritje prej 'hero', Haradinaj elektrizon shqiptarët në Amerikë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj është prituri si 'hero' nga komuniteti shqiptar në Miçigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Zyra e shtypit të kryeministrit, njofton se Haradinaj është ftuar nga "Komuniteti Katolik Shqiptar, Shën Pali, në Detroit, për të marrë pjesë në shënimin e 108-vjetorit të Kryengritjes së Malësisë. Axbhenda e tij është tejet e ngjeshur, ndërsa në protokoll është parashikuar të zhvillojë një sërë takimesh me përfaqësues të komunitetit katolik shqiptar në Amerikë. "Do të ketë takime edhe me përfaqësues të komunitetit shqiptar katolik në Amerikë dhe autoritete të Detroitit. Gjatë kësaj vizite, kryeministri Haradinaj do të takojë edhe zyrtarë të tjerë të SHBA-së", thuhet në tejet në njoftim. Pritja e shqiptarëve ishte madhështore për Kryeministrin e Kosovës, ndërsa në sallë dëgjoreshin thirrjet "UÇK dhe Haradinaj". Gjithashtu, nuk kishin si të mungonin në sallën ku mbahej takimi simbolet kombëtare, veshjet tradicionale të kulturës shqiptare, të cilat vijojnë të ruhen me fanatizëm nga Diaspora jo vetëm në Amerikë, por edhe në vendet e tjera të botës.

SHBA 'mbështet

rikthimin' e Kosovës dhe të Serbisë në dialog

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq tha se Kosova ka braktisur dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë pa e përmbyshur obligimin për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, duke i vënë taksë mallrave të importuara nga Serbia, duke miratuar një platformë për negociatat dhe duke formuar ushtrinë. Vuçiq i bëri komentet në një takim me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Beograd, Kyle Scott. Ai tha se bashkësia ndërkombëtare është dashur të merret me herët me problemet që kanë qatur në ndërprerjen e dialogut, në veçanti me përpjekjet për të shfuqizuar taksën mbi mallrat serbe. "Nuk jam optimist, por, nëse Prishtina e tërheq taksën, Serbia është e gatshme të bisedojë", tha Vuçiq, transmeton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropë e Lirë. Scott, në anën tjetër, tha se SHBA-ja e mbështet rikthimin të dialogu dhe se është e domosdoshme që të gjenden mënyra për vazhdimin e tij. "Është interes i përbashkët i Serbisë dhe i Kosovës, si dhe i komunitetit ndërkombëtar që të arrihet kompromisi", tha Scott. Kosova u ka vënë taksë 100% prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina qysh në nëntor të vitit të kaluar. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se taksa do të mbetet në fuqi derisa Serbia ta njohë Kosovën, ndërsa Vuçiq ka thënë se dialogu nuk mund të vazhdojë pa u hequr taksa.

Përgjakën plazhet e Rodosit, gjenden kufoma të paidentifikuara në breg

"Zaptohet" kufiri greko-maqedonas nga emigrantët

Thashethemet ngrenë në këmbë refugjatët në Greqi



MPA". Nga ana tjetër, zëvendëskryeministrja dhe ministere Mbrotjtjes e Maqedonisë së Veriut Radmila Shekerinska ka lajmëruar përforcimin me forca ushtarake të kufirit me Greqinë për shkak të flukutit të ri të refugjatëve nga shteti fqinj. "Jemi të përgatitur të përballlemi edhe me rritje të presionit", deklaroi Shekerinska gjatë një aktiviteti për NATO-n me të rinjtë në Shkup. "Gjatë ditës së djeshme u konsultuam edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe jemi të gatshëm të përballlemi me rritjen e presionit në kufi. Është me rëndësi të jemi vigjilentë deklaroi Shekerinska. Parlamenti ka marrë vendim që në gjendje urgjente krize të kemi në kufi forca ushtarake, madje edhe në periudha kur duket se rreziku kishte kaluar. Rreziku i shpër-

thimit të një krize të re refugjatësh në kufirin me Greqinë mund të krijohet përmes natës", tha Shekerinska. Para disa muajsh rreth 300 irakianë dhe sirianë bënë rezistencë në përpjekje për të rrezuar pengesën e murit me tela me gjemba midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut në shenjë proteste kundër uljes së numrit të migrantëve të autorizuar të kalojnë në këtë shtet për të mundësuar kalimin drejt Evropës Veriore. Edhe Hungaria po ashtu ka ngritur një gardh të lartë me tela me gjemba në kufijtë me Serbinë. Ndërkaq ditën e diel janë gjetur trupat e tre meshkujve në plazhet e Rodosit. Fillimisht, kufoma e një burri u gjet ditën e shtunë në pasditë në plazh midis Afandou dhe Kolymbia dhe në mëngjesin e së dielës, një kufomë u gjet në zonën e

SHKURT

Maqedoni e Veriut, ministrinë nuk respektojnë gjuhën shqipe

Nga 22 ministri, pesë prej tyre në faqet zyrtare të internetit nuk respektojnë ligjin për përdorimin e gjuhëve. Qeveria dhe 17 ministrinë e mbetura edhe pse ofrojnë mundësinë që faqet të mund t'i kalojnë edhe në gjuhën shqipe dhe atë angleze, materialet në këto dy gjuhë nuk janë të përditësuara. Në lidhje me rastin ka pasur edhe një reagim nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, e cila pohon se çdo ministri është vet përgjegjës për përditësimin e faqes. Maksimalisht çdo ministri është vet përgjegjës. Një pjesë e faqeve nuk janë të unifikuara dhe nuk posedojnë standardet e nevojshme për përditësimin" shprehen nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë. Në faqen e qeverisë dhe të të gjitha ministrive, kur të njëjtat i kthejmë në gjuhën shqipe, kategoritë figurorë shqip, por materialet brenda në nënkategoritë janë në gjuhën maqedonase. Nga 22 ministri, dy faqe zyrtare me të njëjtin dizajn nuk i gjen dot. Disa prej tyre janë ndërtuar 10 vjet më parë dhe nuk plotësojnë standardet për t'u quajtur të tilla, pasi më shumë luajnë rol informues dhe jo urë lidhëse për transparencë me qytetarët. Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë shprehet se së shpejti do të zgjidhet të dyja problemet, zbatimin e plotë dhe të drejtë të gjuhës shqipe dhe unifikimin e faqeve në strukturë dhe pamje. Maksimalisht Ministria e Informatikës dhe qeveria po shqyrton mundësitë për financim dhe procesin e krijimit të faqeve të reja të ministrive, në mënyrë që të bëhet unifikimi i strukturës dhe pamjes. Mësohet ndër të tjera se së shpejti për këtë qëllim do të formohet edhe një grup pune. Faqet e reja do të të përmblajnë edhe standardet për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha faqet do të funksionojnë në gjuhën shqipe dhe atë maqedonase. Sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve, Institucionet kanë një afat prej 6 muajsh.

Glystra Afandou dhe një e dyta në Falirak. Trupi i gjetur të dielën në Falirak, ishte i veshur me një xhakatë të zeze, ndërsa ai që u gjet në Afandou kishte veshje karakteristike, bluzë me mëngë të gjelbër dhe

trup blu, pantallona xhinse dhe çorape. Hetimet për të zbardhur ngjarjen i ka ndërmarrë Autoriteti Qendror Port Rodos, ndërsa trupat e gjetur po ekzaminohen nga mjeku ligjor.



Sot zgjedhjet, cilat janë sondazhet, liderët e perspektivat

# 6 milionë persona votojnë, çndodh me Izraelin pas 9 prillit

## Pritshmëritë për të fituar kryeministri Netanyahu

Do të jenë rreth 6 milionë izraelianët, me përjashtim të qytetarëve që banojnë jashtë vendit, të cilët sot, në 9 prill, ditë e shpallur festë kinse për të favorizuar pjesëmarrjen në votime, do të thirren që të shprehin me rastin e zgjedhjeve politike të parakohshme. Knesseti, parlamenti njëdhomësh i përbërë nga 120 ulëse, do të rinovohet për të 21-ën herë nga krijimi i tij. Partia apo koalicioni, me një prag hyrjeje të fiksuar në 3.25%, që do të arinte të siguronte të paktën 61 vende do të fitonte mazhorancën absolute, duke udhëhequr atë që do të jetë qeveria e 35-të e historisë së Shtetit të Izraelit. Pjesëmarrja e arritur në zgjedhjet e fundit të mbajtura më 17 mars 2015 ka qenë 65.7%. Rezultatet nxorën afirmimin e Likudit, partisë së qendrës së djathtë të Kryeministrit aktual Benjamin Netanyahu. Izraeli vjen në zgjedhjet e parakohshme me vetëdijen se cilado parti që do të drejtojë qeverinë e re nuk ka sesi të mos vendosë në krye të axhendës së saj temat e sigurisë së brendshme, me referime të natyrshme ndaj çështjeve palestineze, dhe të sigurisë rajonale, të përfaqësuar nga kërcënimi shtetë që nga Irani shtrihet në Liban, duke kaluar nëpër Siri në kurriz të Lartësive Golan, zonë me potencial të lartë strategjik dhe simbolik. Rezultati i votimeve rezultoi mjaft i paqartë, pasqyrë e një vendi i detyruar që të mbrojë identitetin e tij megjithëse duke ju dashur të rinovohet, në mos në ideologji,



në planin e progresit teknologjik, ushtarak dhe shkencor. Elektorati është i vetëdijshëm se sot Izraeli, edhe prej politikës së guximshme të kryeministrit në largim, përfaqëson një vend të fortë dhe të avancuar, në rritje në planin e marrëdhënieve diplomatike, të dëshmuara nga raportet me Indinë, Brazilin, vendet e Azisë Qendrore e shumë shtete afrikane, dhe në posedim rezervash të konsiderueshme energjetike offshore (vendburimet Leviathan e Tamar), me tregues pozitivë makroekonomikë. Por gjithë kësaj i mbivendoset një realitet shumë fetar, entropik, multietnik dhe gjithmonë në luftë me një armik ideologjik e fizik, që me shka llë të ndryshme, shërben si agregues dhe bashkues i shpirtave dhe i tribuve të ndryshme të tij. Sipas sondazheve të fundit parazgjedhore, lista "Blue and White" e ish-Shefit të Shtabit

të Përgjithshëm të forcave të armatosura izraeliane Benny Gantz dhe e Yair Lapid, liderit të partisë së qendrës Yesh Atid, duhet të sigurojë vetëm 32 ulëse në Knesset, ndërsa Likudi i Netanyahu vetëm 28. Partia Laboriste do të fitonte vetëm 8 ulëse, duke konfirmuar një tendencë negative që zgjat prej të paktën një dekadë, akoma më shumë e amplifikuar nga paqartësitë e Avi Gabbay dhe dalja nga skena politike Tzipi Livni, figurë historike e progresizmit sionist. Në terma të koalicioneve të mundshme, blloku i së djathtës nacionaliste, i drejtuar nga Likudi, do të arinte ka shumë të ngjarë në 64 ulëse, falë mbështetjes së partive fetare dhe ultraortodokse, përfaqësues të kolonëve në Cisjordani, ndërsa koalicioni i drejtuar nga Gantz plus Partinë Laboriste dhe progresistët e Meretz, që në zgjedhjet e fundit nuk e kanë kaluar pragun,

do të kishte 56 ulëse. Rezultati i votimeve i paqartë, mbi të cilin do të peshojnë vlerësimet e izraelianëve, pikërisht pak ditë pas lëshimit të papritur të raketave të ardhura nga Rripi i Gazës që kanë goditur, në distancën e 5 viteve, distriktin e Tel Avivit, seli e puthuajse të gjitha ambasadave të akredituara, dhe jo vetëm, si normë, rajonet jugore të territorit, gjithmonë të ekspozuara ndaj terrorizmit të Hamasit. Kështu, më mirë të synohet në një sistem tashmë të kolauduar dhe në thelb fitimtar edhe në terma të përvosjes dhe marrëdhënieve të "rënda" (Kryeministri Netanyahu ka takuar ditë e fundit Trump dhe Putinin), apo t'i drejtohet një projekti të ri që shikon tek Benny Gantz një interpretues të besueshëm të një periudhe të gjatë, edhe në arsye të procesit gjyqësor në priftje nga i cili Netanyahu domosdoshmërisht do të duhet të mbrohet? Rezultati elektorale do të përfaqësojë një referim për kreun e shtetit Reuven Rivlin, i cili do të ketë në dispozicion 42 ditë nga mbyllja e kutive të votimit që të nisë konsultimet për t'ia caktuar detyrën e formimit të ri ekzekutiv të ri një figure të individualizuar në politikanin me më shumë shanse që të sigurojë një mazhorancë të qëndrueshme. Nuk përjashtohet që të mund edhe të rikthehet sërish në votime, ndoshta në nëntor, në rast të një skenari ngërçi dhe paqartësie. Megjithatë, duket më shumë e mundur që njëri midis Netanyahu dhe Gantz, me këtë të fundit të gatshëm që të pranojë në qeverinë e tij edhe par-

### Libi: Këshilli i Sigurimit të OKB kërkon t'u jepet fund luftimeve

Këshilli i Sigurimit të OKB kërkon që trupat e gjeneralit Krenegat libian, Chalifa Hafitar të ndalojnë marshimin e tyre drejt Tripolit. Edhe ministrat e Jashtëm të grupit të G7 kërkojnë t'i jepet fund ofensivës. Këshilli i Sigurimit të OKB tha se është "shumë i shqetësuar" për ofensivën e trupave të gjeneralit të fuqishëm, Chalifa Hafitar. Të ashtuquajturës Ushtria Nacionale Libiane (LNA) e Chalifa Hafitarit, i kërkohej "të ndalojë të gjitha lëvizjet ushtarake", tha ambasadori gjerman në OKB, Christoph Heusgen mbas një takimi të thirrur urgjentisht në Nju Jork. Gjermania mban kryesinë e Këshillit të Sigurimit. Organizmi i OKB do të verë para përgjegjësisë për përshkallëzimet e reja në Libi të gjithë përgjegjësit, shtoi Heusgen. "Në këtë konflikt nuk mund të ketë zgjidhje ushtarake." I ngarkuari i posaçëm i OKB me Libinë, Ghassan Salame informoi Këshillin e Sigurimit në një takim me dyer të mbyllura për situatën aktuale në vendin afrikano-verior. Që prej rrëzimit të detyruar me forcë me ndihmën edhe të perëndimit, të pushtetmbajtësit Muammar al - Gaddafi, në vitin 2011, në vend sundon kaosi. Luftëtarët e Hafitarit duan që të marrin kryeqytetin libian, Tripoli. Atje ndodhet në pushtet qeveria e njohur nga ndërkombëtarët e kryeministrit Fajis al-Sarradsch, i cili është në garë për pushtet me Hafitarin, për të drejtuar vendin e pasur me naftë. Gjenerali renegat përkratet nga Rusia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Egjipti. Po ashtu si qeveria e Saradsch-it edhe LNA e Hafitarit është e lidhur me shumë milicë lokale. Në afërsi të Tripolit milicët besnikë të qeverisë kanë zhvilluar luftime të ashpër me trupat e Hafitarit. Një zëdhënës i LNA, deklaroi se luftëtarët e Hafitarit kontrollin mbi aeroportin ndërkombëtar që ndodhet në rrethinat jugore të qytetit. Para mbajtjes së takimit në Këshillin e Sigurimit të OKB, ministrat e Jashtëm të G7 kërkuar ndalimin e menjëhershëm të luftimeve në Libi. Palët në konflikt duhet t' i japin fund menjëherë "të gjitha aktivitetet dhe lëvizjeve të trupave rreth Tripolit", deklaruan në Dinardin e Francës ministrat e mbledhur për konsultime. Luftimet e fundit në afërsi të Tripolit përguan përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për të arritur një proces politik në vendin e kapluar nga lufta civile, thuhet më tej. Njëpërmjet dhunës së re vihet në rrezik jeta e civilëve.

titë ultraortodokse, të cilave do të duhet bërë lëshime të konsiderueshme jo të pëlqyeshme nga një pjesë e mirë e shoqërisë laike, që të arrijë të formojë një ekzekutiv, përberja e të cilit do të kalojë prej mbështetjes së nevojshme të partive të vogla, me përjashtim të atyre arabe historikisht në opozitë. Midis këtyre, peshën më të madhe mund ta ketë Zehut, partia e ekstremit të djathtë e Moshe Feiglin, ish-zëdhënësit të Likudit, që e quan veten libertare. Zehut, në favor të aneksimit të Territoreve të Pushtuara dhe ndaj anulimit të Marrëveshjes së Oslo, ka futur në programin e saj elektorale legalizimin e

kanabisit, duke e vendosur si kusht për mbështetjen e saj eventuale ndaj çdo koalicioni qeverisës. Nga premissa të tilla rezultoi e qartë se 2019 paralajmërohet si një vit vendimtar për izraelianët. Por do të jetë domethënëse edhe për bashkësinë ndërkombëtare, e thirrur që të dialogojë me një vend krenar, me rrënjë të lashta dhe, në të njëjtën kohë, ambicioz dhe i përparuar, në gjendje që të lëshojë edhe sondën e tij të parë honore, të quajtur Bereshit, e cila përbman një kapsulë të kohës dixhitale me 50 milionë faqe të tjera me të dhëna, midis të cilave Dhia e Vjetër.

### Jep dorëheqjen sekretarja amerikane e Sigurisë Kombëtare

## Kirstjen Nielsen: Nuk jam mjaftueshëm e ashpër për t'i pëlqyer Shtëpisë së Bardhë



gjykatave në rregullimin e ligjeve që kanë penguar aftësinë tonë të siguruar plotë

sisht kufijtë e Amerikës dhe që kanë kontribuar në mosmarrëveshjet në vendin tonë. Burrat dhe gratë e Departamentit të Sigurisë Kombëtare, meritojnë të kenë të gjitha mjetet dhe burimet e nevojshme për të zbatuar misionin që u është besuar". Zonja Nielsen më vonë shkroi në Twitter se dita e saj e fundit në post do të jetë e mërkura. Presidenti Trump ka shprehur zhgënjimin me situatën për gjatë kufirit të Shteteve të Bashkuara me Meksikën, ku janë drejtuar qindra e mijëra emigrantë në përpjekje për t'i shpëtuar

varfërisë dhe krimin në Amerikën Qendrore, me shpresë për të hyrë në Shtetet e Bashkuara. Ai riktheoi qëndrimin e tij në një seri komentesh në Twitter të dielën vonë duke i nënvizuar ato me pohimin se "Vendi ynë nuk mban më!". Burimet në Shtëpinë e Bardhë thonë se presidenti Trump qortonte shpesh zonjen Nielsen se nuk po tregohet mjaft e rreptë në frenimin e numrit të emigrantëve që po përpjekshin të hyjnë në Shtetet e Bashkuara. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, i quajti politikat

e emigracionit të administratës së president Trump "mizore" që sipas saj, "vetëm sa kanë përkeqësuar vuajtjet njerëzore në kufi". "Është thellësisht alarmuese që zyrtarja e administratës Trump që ka futur fëmijët nëpër kafaze, thuhet se po jep dorëheqje meqë nuk është mjaft e ashpër për t'i pëlqyer Shtëpisë së Bardhë", tha ajo, "Amerika ka nevojë për një sekretar të Sigurisë Kombëtare që do të respektojë shenjtërinë e familjes, do të nderojë trashëgiminë tonë krenare si komb i emigrantëve dhe do të rivendosë mendjen e shëndoshë në politikën e kësaj administrate". Zonja Nielsen u përball me protesta publike për shkak të politikës shumë të papëlqyeshme të administratës për ndarjen e familjeve emigrante pas

hyrjes në SHBA. Mijëra fëmijë u ndanë nga prindërit e tyre dhe u mbajtën në mjedis të ndara. Zonja Nielsen ishte përgjegjëse për zbatimin e asaj politike ndonëse atëbotë e mohonte një gjë të tillë. Në letërn e saj zonja Nielsen shkroi se "atdheu ynë sot është më i sigurt sesa kur iu bashkova kësaj administrate. Kemi ndërmarrë veprime të pashembullta për të mbrojtur amerikanët". Presidenti Trump falënderoi në Twitter zonjen Nielsen për shërbimin e saj dhe njoftoi që komisionari i doganave dhe mbrojtjes së kufijve, Kevin McAleenan, do të jetë ushtrues detyre i sekretarit të Sigurisë Kombëtare. "Kam besim që Kevin do të bëjë një punë shumë të mirë", -tha presidenti Trump.

Kirstjen Nielsen, sekretarja e Departamentit amerikan të Sigurisë Kombëtare, ka dhënë ditën e djeshme dorëheqjen pas 16 muajsh në këtë post dhe trysinë së madhe nga Shtëpia e Bardhë dhe publiku mbi situatën për gjatë kufirit jugor të vendit. "Me gjithë përpërimin në reformimin e sigurisë kombëtare për epokën e re, kam vendosur që është koha e duhur për t'u larguar" shkroi zonja Nielsen në letërn e dorëheqjes dërguar presidentit Donald Trump. Ndonëse nuk tha saktësisht se pse po ikte, zonja Nielsen, shkroi se shpreson që sekretari i ardhshëm "do të ketë mbështetjen e Kongresit dhe

## EKSPOZITA

Imazhi përmbyllës duket si nënteksti i gjithçkaje çfarë artisti propozon. "art is politic - politic is art". Ky binom i mbivendosur duket për një moment si strumbullari i pafund i gjithçkaje.



Fatmira Nikolli

**E**kaluara përkufizohet si bashkësia e ngjarjeve të ndodhura. Është ai dimension i kohës kronologjike, që përkufizohet nga hapësira kohore të jetuara. Është ajo copëz kohore, e cila, e propozuar në një linjë lineare, i kundërvihet të ardhmes, duke u ndarë qartësisht dhe nga e tashmja. Kuratori Ermir Hoxha në një tekst shoqërues ndalet gjatë te mesazhet.

Në Galerinë FAB, në ekspozitën e tij të fundit, artisti Ardian Isufi, ripropozon të shkuarën si një matricë të pandashme nga e tashmja. Ai e ndan atë në dy seksione, i pari, "Një herë e një kohë... Në kohë edhe njëherë" dhe i dyti, "Pa titull... Në kohë". Të dy këto seksione ndahen qartazi edhe nga formati: tek i pari, artisti i ngre ekspozitën si një skenografi, ku tablotë në çifte, propozohen si pasqyra të një realiteti të trishtë, ndërsa tek i dyti ai projektton një video të ndarë sërish në dy imazhe. Hoxha shënon se në dy sallat e para tablotë propozohen në formë rrethuese, në distancë anësore nga muri, për të arritur një efekt skenik konkvav. Imazhi i parë hyrës është një minare e shembur, ftesë për t'u futur në një hapësirë, ku forca të dukshme e të padukshme veprojnë prej shekujsh. Si gjurmë "arkeologjike", ajo shfaqet e zbehtë, pretenduese e destruktive. Pas kësaj fantazme të mbetur nga revolucioni i hershëm antiklerikal, ndodhet një tjetër imazh "bashkëkohor", grotesk gati në çdo milimetër. Ai është një objekt i lartë, i identifikueshëm si oxhak industrial, që kulmon shkëlqyes nga një majë e improvizuar minareje. Oxhaku, motiv krenarie i sistemit të kaluar është transformuar sot nën tingujt e rizgimit religjioz. Dy imazhet simotra ironizojnë me fatin e njëra-tjetrës, aq sa nuk kuptohet kush gëzon fatin më mjeran. Sipas Hoxhës, tablotë e tjera që plotësojnë sallën ndjekin njëra-tjetrën. Fillimisht një kioskë strehohet pa shumë pretendime në skajet e një qendre urbane, e ndër-sa logot e shërbimeve mbivendosen, në krah, e mjeçullt, shfaqet monumenti madhështor i Vlorës, vepër epike e krenimit të pavarësisë së vendit tonë. Në krah, sheshi i kombinatit "Stalin" duket i rizgjuar në një mëngjes herët, me monumentin e munguar. Rreth tij shëtisin kuturu hije, që duket se mungesa e monumentit i ka përcaktuar një humbje orientimi të

# ARDIAN ISUFI: Fantazma e mbetur nga revolucioni antiklerikal

*Çelet ekspozita "Once upon a time... in time once again!"*



dukshme. Më tej, akoma në dy imazhe nga qendra e kryeqytetit (Under Construction), bashkëjetojnë skelat e rindërtimit; "grataçelat" Made in Albania, strukturat e bronzta ngritur me pasion nga regjimi komunist, reklamamat e botës së sotme e figura triumfuese të Luftës Nacionalçlirimtare. Ato herë përshëndesin njëra-tjetrën e herë në heshtje duket se kanë pranuar ironinë e fatit. Dhe akoma më tej, thotë Hoxha, në mbyllje të skenës së improvizuar prezantohen edhe njëherë dy statuja rrethuar nga struktura gjigante industriale. Si gardian pa kohë e pa qëllim, ato vështrojnë larg, në një pikë të papërcaktuar, si heronjtë e heshtur të komunizmit internacional. Në sallën majtas, imazhi i parë, vendosur në qendër të sallës (një grup stereotipash të shoqërisë socialiste përfshirë nën një shi festiv imagjinar), duket sikur dialogon ironikisht me një mesoburrë "ish-partizan", ulur në trotuar, që sot shet tollom-baze shumëngjyrëshe. Ura kohore që ngrihet mes këtyre personazheve ngjyrosset me nota të forta melankolie, mes ëndrrave e iluzioneve të humbura.

Tablotë e tjera që ndjekin linjën ekspozitive, ripropozojnë herë objektet të kaluarës e herë të tashmes. Më pas, akoma ripropozohet koperina e romanit "Dimri i Madh". Tashmë i pastruar nga festiviteti qiellor e në gjuhë të huaj, si objekt i denjë eksperti i kohës dhe si një nga pikat më të larta të ngritjes së kultit të individit, ai rikujton stereotipat delirantë e euforikë, mbrojtës të vijës së socializmit shqiptar, shkruan Hoxha.

Imazhi përmbyllës duket si nënteksti i gjithçkaje çfarë artisti propozon. "art is politic - politic is art". Ky binom i mbivendosur, duket për një moment si strumbullari i

pafund i gjithçkaje. Një rreth vicioz, ku duket se asgjë nuk i shpëton dot dorës së padukshme e matricës së vendosur nga forca e kohës.

Por, pika më e lartë e ekspozitës mbetet salla e majtë. Në miniaturë, vëren Ermir Hoxha, ajo propozohet si kinema "Republika", e pajisur me tabelë, poster, karriget e kohës dhe objekte të tjera antikuare. Projektimi i dalë nga goja e një prozhektori gjigant tregon një imazh kinematografik të ndarë në dy plane. Tek i pari copëza të filmit "I Teti në Bronz" rindërtojnë udhëtimin e bustit e "heroit", e tek tjetri ripropozohet rrugëtimi i monumentit të "njeriut të ri socialist", që artisti solli në galeri në ekspozitën e kaluar. Të ndarë në dy ekrane, e shkuara dhe e tashmja lozin me gjeistin artistik, nostalgjinë dhe ndërthurjen e tyre. Në një montazh mjaft të arrirë, si një eko e kohës, vlerat dhe antivlerat, i lenë vendin njëra-tjetrës, si një paralelizëm paradoksesh të së shkuarës me të sotmen.

Ekspozita, në tërësi është zgjatim i kërkimit artistik të viteve të fundit të artistit A. Isufi duke rihapur edhe njëherë diskutimin mbi monumentalitetin, si sjellje, dije dhe sot. Ajo heton të shkuarën e afërme, atë që është ende mes dhe brenda nesh. Ajo herë thërret për vlerat e humbura, e herë qëndron si roje e tyre.

Monumentaliteti në këtë ekspozitë, herë përkthehet në skulpturat simbol të regjimit të kaluar, herë në objekte të periferive të haruara, e herë të tjera në personazhe të trishtë të realitetit që jetojmë. Mesa duket, do të jetojmë me to si në një pikë të madhe grumbullimi, me durim siç vetëm në dimë të durojmë, ose të bëjmë më të vështirën, siç shkruante Lubonja: "... t'i bëjmë të padëmshëm, duke i goditur mu atje ku duket se kanë fuqinë e tyre: tek madhështia".




BOTIMI

Fatmira Nikolli

# YLLJET ALIÇKA

## Historia e familjes Popa botohet në Francë

T'i thuhet e vërteta: Udhëheqësi i lartë i Partisë nuk ka nevojë për lotët e tu. Kurseji lotët kur të vdesë ndonjë borgjez, apo pipino fashist, kësh-tu i thuaj! (Ylljet Aliçka "Valsi i lumturisë", f.9, Toena). Sapo është botuar në Francë romani "Valsi i lumturisë", i shkrimtarit Ylljet Aliçka, botuar nga shtëpia e njohur botuese "L'esprit du temps", përkthyer nga Michel Aubry (Mishel Obri). Në parathënien e këtij botimi në gjuhën frënge, shkrimtari Ismail Kadare shkruan ndër të tjera: "Një roman i shkruar me art dhe dinjitet", ndërsa botuesi francez shkruan për këtë libër: "Një rrëfim jashtëzakonisht ironik dhe absurd, i frymëzuar nga një histori e rrallë, ku zbulohen dy botë, gjë e rrallë kjo për romanin tradicional. Është kjo qasje që e bën letërsinë e Aliçkës origjinale dhe njerëzore". Ndërsa pas botimit të këtij romani në Itali, gazeta "Corriere della Sera" ka shkruar "Qesh hidhur tek lexon këtë roman, e megjithatë qesh". Ndërsa ish-ambasadori italian në Shqipëri, Mario Bova shkruan në revistën "L'Indic": "Si vepër letrare, "Il sogno italiano" ("Valsi i lumturisë") i kapërcen fuqishëm kufijtë e një hapësire kombëtare e lokale, për të arritur fuqinë e një reflektimi mbareuropian, për tragjedinë e tmerrshme të fenomeneve të emigracionit drejt kontinentit". Romani "Valsi i lumturisë", i botuar nga shtëpia botuese "Toena" mbështetet në një ngjarje të vërtetë. Në dhjetor të 1985-ës gjashtë anëtarët e familjes Popa hynë ilegalisht në ambasadën italiane. Rasti i tyre bëhet çështje ndërkombëtare për Shqipërinë e vogël e të izoluar. Familja Popa, një familje e thjeshtë nga Durrësi hyn tinëzisht (duke u hequr si turistë) në ambasadën italiane dhe aty kërkon menjëherë strehim politik. Shteti totalitar shqiptar pëson një tronditje të madhe nga ky gjest. I quan shtetasit e vet "kriminelë". Një gjë të tillë, kush kishte guxuar ta bënte më parë, ishte pushkatuar. Ngjarja që erdhi nga këta njerëz të thjeshtë mori përmasa të paparashikueshme ndërkombëtare. Gjashtë anëtarët e familjes Popa, nga



frika e dënimit, deklaruan se do të vetëvriteshin, nëse ambasadori italian i dorëzonte në duart e Sigurimit të Shtetit shqiptar. Ata u mbrojtën për rreth 5 vjet në ambasadën italiane, veprim që u bë shkak për tensionimin e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, por edhe shkak për kthimin e vëmendjes të ndërkombëtarëve drejt Shqipërisë. Ambasada italiane rrethohet me mbi 600 mijë policë. Përtej brigjeve, televizioni italian transmetonte ngjarjen reale nga Tirana. Komisioni i çmimit "Ballkanika" ka përzgjedhur për vitin 2014 shkrimtarin Ylljet Aliçka me roma-

*Kadare: Një roman i shkruar me art dhe dinjitet*

nin "Valsi i Lumturisë" për të përfaqësuar Shqipërinë. I shkruar para disa vitesh, ky roman është fitues i çmimit kombëtar "Pena e argjendtë" për 2012-n, që ndan Ministrinë e Kulturës. Shkrimtari Ylljet Aliçka përfaqësoi letërsinë shqipe në "Netët e letërsisë europiane 2012-2014". Ai ishte përzgjedhur në projektin "10 shkrimtarë bashkëkohorë që prezantohen mes arrietjeve të letërsisë së sotme europiane". Ky është një projekt ndërkombëtar,

partneritet i Bashkimit Europian me qytetet Brno, Bukuresht, Dublin, Lisbonë, Vilnius, Pragë dhe Wrocław.

"Autori e mbyll me një postscriptum therës, një mësim elokuent për shoqëritë dhe politikën, përmbajtjen e të cilit Aliçka e merr nga një denoncim i shfaqur në shtypin italian të kohës nga ana e një shoqate kulturore milaneze: "Dymbëdhjetë vjet pas mbërritjes së tyre

në Itali, askush nuk mendoi të gjente një zgjidhje të përshtatshme e dinjitoze për familjen Tota, as ndonjë përkrahje nga ana e shërbimeve sociale vendëse. Si pasojë, ajo që ishte një problematikë me karakter politik e shoqëror, çuditërisht u shndërrua në një problem të rendit publik", ka shkruar Mario Bova në median italiane.

Ai ka vërejtur se vepra, e kufizuar në një periudhë të caktuar kohore, nuk mëton të parashtrojë vlerësime dhe komente për ngjarjet e emigracionit mesdhetar të viteve të fundit. Por, thellësia e gjykimeve ka dobi të jashtëzakonshme për një krahasim efikas me këto të fundit, duke vënë në pah përsëritjen e shkaqeve shoqërore dhe të gabimeve politike. Si vepër letrare, "Il sogno italiano" ("Valsi i lumturisë") i kapërcen fuqishëm kufijtë e një hapësire kombëtare e lokale, për të arritur fuqinë e një reflektimi mbareuropian, për tragjedinë e tmerrshme të fenomeneve të emigracionit drejt kontinentit. Ndërsa Agim Baçi ka shënuar: "Nuk është thjesht një homazh për diktaturën. Është një homazh për atë që nuk e zhbëmë dot siç duhet. Dhe kur përplasemi me gjithë furinë e dëshirave drejt ëndrrës sonë, mundet që të këputemi në gjunjët e realitetit të parë". Totajt, përmes penës së Aliçkës udhëtojnë drejt "Lirisë që duhet ta administrojnë me të tjerë". Atje ku përditshmëria ka tekut e veta. Kur heronjtë marrin trajta të ndryshme. Po ku është njeriu? Është diku me shumë sesa një kërkesë në liri. Është dinjitet. Është ngritje pas rrëzimit. Por ëndrra i ka lodhur Totajt e Aliçkës. Dhe arrijmë në pyetje pa fund, por ndoshta të vetes, që na duhet t'u përgjigjemi fuqishëm dhe pa u ndalur: A do të dimë ta lexojmë fatin tonë?"





**BLUE TOOTH**

THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA



te rejat nga jeta ipave

con të shtuna falas me

Letra  
e Ditës

# Një përgjigje për Elez Biberajn

Nga Edi Rama

(vijon nga faqja 1)

... historinë e një marrëdhënieje të posaçme në distancë, krijuar tash e thuasje 30 vjet më parë, në momentet e lavdishme të Zërit shqiptar të Amerikës, ma imponon që t'Ju drejtohem publikisht.

E gjej për të ardhur keq gjuhën e përdorur prej Jush lidhur me qeverisjen time. Aspak jo pse Ju jeni kritik për të. Por sepse, në sh-tjellën Tuaj ka më shumë etiketime fyese e të pavërteta të vrazhda, se sa argumente e fakte burimore.

Duke iu referuar shembullit të disa udhëheqësve të tjerë europiano-lindorë, Ju thoni ndër të tjera se, "Rama është bërë dukshëm më i korruptuar"! Nuk po merrem këtu me etiketimet e tjera. Fundja ato janë opinione dhe është e drejta Juaj të mendoni, se unë qenkam bërë "më autoritar, më arrogant dhe më jo transparent".

Por desha t'Ju pyes zoti Elez, a e dini Ju se "i korruptuar" është akuzë ligjrisht e rëndë e jo opinion dhe a keni Ju ndonjë provë për ta mbështetur këtë akuzë?

Natyrisht, kjo është një pyetje retorike. Sepse deri më sot, askush nuk ka sjellë dot asnjë provë, për ta mbështetur etiketimin e rëndë "i korruptuar", lëshuar rëndom në adresën time nga palë e individë të angazhuar publikisht, në fushata a në maskarada të shumta kundër meje. Por personi im ka lidhje me këtë etiketë, aq sa ç'ka lidhje kjo lloj gjuhe me gazetarinë e vërtetë!

Më tej, sipas Jush, unë paskam "ngushtuar hapësirën publike, minuar institucionet e pavarura, mbushur gjyqësorin me besnikë nën maskën e reformave"! Ama për çudinë më të madhe, tërë këto thagma i paska zbuluar vetëm opozita, disa media 'online' pranë saj dhe disa të vetëdeklaruar analistë - të cilëve Ju i bashkoheni, duke përsëritur akuzat e tyre një për një dhe me të njëjtën vrazhdësi.

Unë në fakt, zoti Elez, e pranoj dhe e pranoj me krenari, se kam minuar një sistem të tërë të kalbur e të korruptuar drejtësisë! E kam bërë hapur dhe vendosmërisht, duke marrë përsipër çdo risk e kosto të mundshme politike dhe jo nën maskën e një reforme, po përmes pikërisht Reformës në Drejtësi. E cila është mbështetur dhe vazhdon të mbështetet pa asnjë ekuivok, qysh prej ditës së parë, nga çdo partner ndërkombëtar i Shqipërisë. Madje, konsiderohet prej tyre një model për t'u shtrirë në të gjithë rajonin tonë.

A e dini Ju se partnerët tanë amerikanë dhe europianë e mbikëqyrin këtë reformë në çdo hap edhe përmes një Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit?

Padyshim edhe kjo është një pyetje retorike. Sepse s'ka se si Ju të mos e dini se deri më sot, ata nuk kanë konstatuar asnjë minimum apo cenim institucionesh të pavarura dhe asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi për të futur besnikë në gjyqësor. Përkundrazi, ata e kon-



siderojnë procesin e pastrimit të gjyqësorit jo vetëm të suksesshëm deri këtu, po një garanci për pavarësinë e për besueshmërinë e institucioneve që po ndërtojmë nga themelet, pas dekadash kalbëzimi e rrënim të tyre.

Është befasuese që Ju të flisni për gjyqësor të mbushur me besnikë, sepse e vërteta është që kaq larg s'ka shkuar askush, as brenda vetë oborrit opozitar, përveç Dr.Berishës! Dhe jo se është ndonjë mëkat i paamnistueshëm, që

dikush të përsërisë fjalët e zotit Sali për të shprehur një opinion të ngjashëm, po unë besoj se është e pajustificueshme për një gazetar apo një drejtues tribune mediatiqe, që një akuzë kaq shembullore në pavërtetësinë e saj, t'ia përcjellë audiencës si fakt mbi qeverisjen e këtij vendi.

Ju thoni se unë paskam "refuzuar të dënoj rastet e shumta skandaloze për korupsionin, përfshirë publikimin e përgjimeve" për blerje votash! Madje, u paskam "ofru-

ar pandëshkueshmëri zyrtarëve të lartë edhe përkundër të dhënave të qarta për korupsion dhe bashkëpunim me grupe të krimit të organizuar dhe trafikantëve të drogave".

Pyetja retorike në këtë rast mund të keqkuptohej, prandaj edhe s'po e bëj! Por dua t'Ju kujtoj, se siç Ju nuk jeni as prokuror e as gjykatës, edhe pse në këtë rast keni marrë përsipër ta luani këtë rol, as unë nuk jam prokuror apo gjykatës dhe s'kam ndërmend ta marr përsipër një rol të tillë. Kështu që s'kam as se si dënoj njerëz për çfarëdo qoftë, as se si refuzoj të dënoj kënd. Këtë detyrë e ka drejtësia dhe duhet ta bëjë vetëm ajo. Prandaj edhe Ju s'mund të tregoni dot një rast të vetëm, kur unë apo qeveria ime të kemi ofruar goftë dhe mbrojtje verbale nga drejtësia për këdo qoftë, se pandëshkueshmëri siç bënte rregullisht paraardhësi im dhe qeveria e tij, jo e jo.

Nga ana tjetër, e keni përmendur edhe "Zërin e Amerikës", duke thënë se qenka sulmuar në mënyrë befasuese nga unë. Ju siguroj se ato çka Ju quani sulme befasuese, kanë qenë thjesht shprehjet e singërta të befasisë sime, për faktin e pazakonshëm

se një tribunë e respektuar, me standarde të mira profesionale si VOA, ra nën nivelin e standardeve të veta në dy raste konkrete.

VOA nuk respektoi për fat të keq, asnjë parim profesional në rastin e transmetimit të një përgjimi të nxjerrë nga një dosje hetimore, me një koment të vetin kriminalizues pa asnjë bazë faktike më shumë se sa vetë përgjimi (i cili siç e dini, nuk përbën provë në vetvete, në asnjë gjykatë të botës). Ndërsa në rastin tjetër VOA dizinformoi, duke bërë një mishmash e duke përfshirë persona pa lidhje në "aktakuzën" e vet dhe ende më keq, duke refuzuar publikimin e sqarimit të ministres së drejtësisë, e cila me fakte lehtësisht të verifikueshme mbi punësimet në sistemin tonë penitenciar, e hodhi poshtë "aktakuzën". Si një gazetar e drejtues me shumë përvojë në botën e medias, Ju duhet ta dini se gjysmë të vërtetat e servirura si zbulime, janë edhe gënjeshtat më të mëdha publike.

Ju gaboni krejt kur thoni se sot shqiptarët "duhet të mbështeten tek mediat ndërkombëtare, përfshirë Zërin e Amerikës, për mbulimin e çështjeve të ndjeshme". E vërteta është se në asnjë rast këto vitet e fundit, shqiptarët s'e kanë mësuar një çështje të ndjeshme nga mediat ndërkombëtare apo nga "Zëri i Amerikës", përpara se sa ta kenë lexuar e dëgjuar të komentohet gjerësisht në mediat e vendit.

Ju i quani kërcënuese reagimet e mia ndaj "kazanit" (s'kam gjetur dot një fjalë më të përshtatshme në shqip, për të karakterizuar mallin fake news) edhe pse ato janë "mesazhe dashurie", krahasuar me sharjet brutale e shantazhet nominale të gazetarëve jo shumë vite më parë - atëherë kur kryeministri i Shqipërisë e quante bash gazetën "New York Times" "një letër higjienike"! Asnjëherë si apo sa sot nuk është sharë e baltosur në liri të plotë qeveria e personalisht kryeministri, pa i hyrë gjemb në këmbë askujt, as si person e as si organ mediatiq i çfarëdo lloji. Kështu që pa asnjë merak për lirinë e shtypit në këtë vend zoti Elez, sepse kërcënuesit e vërtetë të saj nuk janë më në pushtet. Me mua, kadrinjve mund t'u hasë sharra në gozhdë kur replikoj, po kurrë s'u has mishi në shkopa veshi në baltë kur konsumojmë shpifje e sharje në mexhelisin mediatiq, sikur të konsumonin raki e djathë në pijetoren e fshatit.

Sa për sfidën e vazhdueshme që unë i paskam bërë "vetë parimit të shtypit të pavarur" duke krijuar mediane time televizive në internet ERTV, më duhet t'ju them se ishte një pasazh që më bëri për të qeshur.

Me shpresën se gjithë sa më lart do t'i prisni si gjithnjë i buzëqeshur, Ju lutem i nderuari mik të pranoi bashkë me konsideratën time të patrazuar, edhe urimet e mia më të singërta për shëndet e punë të mbarë.

Edi



Opinioni **i** Ditës

# Misioni i 13 prillit

Nga Bardh Spahia

(vijon nga faqja 1)

... "popullin" e administratës me vete me autobusë, për t'i paraqitur si kuksiyanë, në kushtet kur pretendon se ke de jure 79 mandate në parlament, e de fakto edhe më shumë, është një absurditet që mund ta realizojë vetëm një mendje aspak e kthjellët. Një mendje e sëmurë, që nuk e kupton se ky vend që po e zbraz ditë pas dite, nuk është aq i madh sa kuksiyanëve të parët, të mos u bjerë në sy "populli" zëvendësues, që ky kryeministër u çoi në shtëpinë e tyre, për një shfaqje televizive, që po vetë e prodhoi. Kam ndeshur indinjatë normale nga miq të njohur e të panjohur, edhe në rrjetet sociale, ndaj atyre që ishin ulur përballë kryeministrit në Kukës e qeshnin, me atë humor të sforuar. Në fakt, realiteti nuk është aq dëshpërues. Natyrisht që ai "popull" i sjellë me komandë me autobusë, po me komandë, edhe do qeshë, pas shakave të lodhura të kryeministrit, që moshë dhe halli i madh që e ka zënë këto ditë i ka prekur edhe cilësinë e batutës. E sigurt se kuksiyanëve që e ndoqën nga pas, me thirrjet "Rama ik", teksa ia mbathi për t'u larguar me helikopter nga Kukësi, nuk u ka ardhur për të qeshur, kur përmes projektit personal vanitoz ERTV, kanë ndjekur spërdredhjet e kryeministrit, që prej kohësh takimet i ka shndërruar në 'stand up comedy', me qëllim argëtimin jo thjesht të atyre që sjell me vete, por të tjerëve, që janë të detyruar ta ndjekin edhe në mediat tradicionale. Padyshim që kryeministri ka gjithë të drejtën të ushrojë ëndrrat e parralizuar, e aktrimi mund të jetë një syresh, ashtu siç bën gazetarin, kryeredaktorin e drejtorin e lajmeve në mediat tradicionale, por jo duke zëvendësuar funksionin për të cilin ka kërkuar e marrë me metodat që di vetë, votën e qytetarëve.

Edi Rama e di mirë edhe nga sondazhet që bën, se qytetarët nuk kanë asnjë arsye të buzëqeshin nën qeverisjen e tij. Si kurrë më parë, një krizë politike e institucionale është kaq flagrante, e thellohet përditë, nën peshën e arrogancës së një kryeministri, që së pari ka kapur pushtetin, që garanton të drejtën në një vend demokratik: drejtësinë. Ata qytetarët në Kukës, që u adreson jo ballazi ndjesën, nuk e harrojnë se si u çoi natën e Pashkëve policinë nëpër banesa, duke u terrorizuar familjet, vetëm e vetëm se protestuan ndaj tarifës skandaloze të traut në derën e shtëpisë, për të kënaqur oreksin e vet makut; se si i zvarriti gjykatave e la në burg protestues pa dallim moshë, sepse kërkuan të drejtën e tyre, atë të drejtë që po ua "njuh", vetëm nga frika e revoltës së tyre. Paradoxikalisht ende mendon se me forcë mund të shtypë qytetarët në të drejtat e tyre, sepse po e përsërit me banorët e Unazës së Re, që ar-restohen se protestojnë kundër një



kryeministri, që ka planifikuar t'u prishë banesat, për hir të një projekti korruptiv, të cilin koha e tregoi se ishte i tillë. Të njëjtën arrogancë pushteti përdori edhe të hënën ndaj banorëve të pjesës fundore të Bulevardit të Ri. Logjika e ngjashme me reformën e Enver Hoxhës së vitit '45: shpronësim i tjetërsim i pronës pa demshpërbim, një akt flagrant që ky kryeministër ëndërron se mund ta zbatojë në Shqipërinë e vitit 2019.

I njëjti kryeministër hesht pacipësisht, edhe kur erdhi e kaloi 1 prilli, data kur kishte premtuar 5 muaj më herët, rritje pagash me 7%, për mjekë, arsimtarë e ushtarakë, e nuk publikon VKM-në përkatëse, aktin ligjor për të materializuar atë akt të rrallë në 6 vjet në karrigen e kryeministrit.

Ka kohë që ky kryeministër nuk qeveris më, sepse është i zënë me arminin e hallevë të ditës, që në fakt i prodhojnë halle të tjera, sepse janë zgjidhje afatshkurtra e jo të qëndrueshme. Mënyra se si po trajton kauzën e studentëve është ilustrimi më i qartë. Vazhdon të punojë fort për fasadën, duke u ofruar vende pune në administratë studentëve ekselentë, pa u zgjidhur 8 kërkesat që vetë studentët gjeneruan në protestat e fundvitit të kaluar. Nga frika se mos përballat me një revoltë të re të tyre, ky kryeministër që shtetin e konsideron si bahçen e vet në Surrel, po i vë shkëlmin së pari

ligjit për administratën publike e bashkë me të, të drejtës së kujtdo, ekselent apo jo, student apo jo, për të konkurruar për një vend në administratën publike.

"Qeverisja" e këtij kryeministri i ngjan një rrumpalle të rrezikshme, pa norma, pa rregulla e pa plan, ku shteti është çdo ditë në shërbim të një njeriu e hallit të tij për karrige e pasuri; ku policia është në gatishmëri maksimale për protesta qytetare kundër kryeministrit, por e pafuqishme e amatore ndaj krimit, që tashmë po godet rehat edhe në qytetet më të mëdha të vendit; ku pasuritë e taksat e këtij vendi abuzohen në mënyrën më të paprecedentë, edhe hapur, ndërsa drejtësisë i janë lidhur duart në mënyrën më flagrante, ndaj çdo akti korruptiv e kriminal, që lidhet me emrin e kryeministrit e të njerëzve pranë tij. Ky është bilanci më i zi, që ky kryeministër po ndërton ditë pas dite me duart e veta, e me tepsinë në dorë.

Prandaj, protesta e thirrur nga opozita më 13 prill nuk është thjesht një akt politik, edhe pse e thirrur nga parti politike. Është një mision qytetar, për të e mos pranuar më shtetin policor në shërbim të një njeriu, që ka kapur çdo institucion në vend, të ndërvarur apo të pavarur me Kushtetutë e ligj. Një kryeministër që mendon se me forcën e kartonëve mund të heshtë opozitën, se me fuqinë e errët të pushtetit, mund t'i japë frymë një

parlamenti nekrotik, me numra fiktivë; se prodhimet e tipit Kinostudio "Shqipëria e Re" mund t'i paraqesë si punë, apo edhe më keq, që shtet për efektivitet numrin e pëlqimeve në rrjetet sociale, të cilat po vetë i komandon përmes strukturave partiake e shtetërore.

Është fatkeqësi që shqiptarët qeverisen nga një individ thellësisht i inkriminuar, që i mungojnë konceptet bazike të shtetit e qeverisjes, pasi kjo krizë politike e institucionale që vetë ka krijuar, falë paafësisë e karakterit të kompleksuar, nuk duhet lejuar të shkojë më tej. Nëse kryeministri do vazhdojë kokëfortësisht të refuzojë ta pranojë, atëherë situatën do ta marrë në dorë populli opozitar: Shqipëria nuk mund të jetë më, maketi ku Edi Rama bën provat e lojërave të munguara të femijërisë, e shfryrur kompleksit e dështimeve të rinisë, në pleqëri. Latinët kanë një shprehje të urtë, e vlefshme jo vetëm klinikisht për mjekët kirurgë, "ubi pus ibi evacua", "aty ku ka qelb, duhet hequr". Zullumet e këtij kryeministri sa vijjnë e majjosen, kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve e të ardhmen e vendit, e ka vetëm një rrugë: terapi sulmi, duke larguar urgjentisht shkakтарin, në mënyrë që vendi të marrë frymë e të rikthehet në rrugën e shpresës e prosperitetit e të vijojë rregëtimin e ndërprerë prej vitit 2013 drejt Bashkimit Europian.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet të shqetësohen shumë për çështjet profesionale, pasi gjërat do të ecin vetë mirë. Sa i përket jetës personale, ka gjasa të përballeni me një problem të vogël, pasi një prej familjarëve mund të shprehë hatërmbetje ndaj juaj.

### DEMI

Demët mund të zhgënjehen në dashuri. Personi që ju mendonit se mund të kalonit jetën, do të dalë jashtë parashikimeve. Demët e martuar mund të dyshojnë në sjelljen e partnerit/partneres. Mos dilni në përfundim pa pasur prova.

### BINJAKET

Disa Binjakë do të shqetësohen për shkak të paraqitjes së jashtme. Ndoshta nuk do të ndiheni mirë për peshës, akneve ose disa njollave në fytyrë. Megjithatë kini besim tek shami juaj natyral. Mund të dilni fitues në disa negociata të vështira me një investitor potencial.

### GAFORJA

Gaforet mund të shfaqin interes për disa projekte të pazakonta, të cilat mund të sjellin përfitime të mëdha. Që të keni sukses, rekomandohet të bëni kujdes të veçantë ndaj çdo hapi që do të hidhni. Gjysma juaj e zemrës do t'ju lënë kënaqësi në çdo moment.

### LUANI

Të lindurit e kësaj shenje nuk rekomandohet të kenë besim vetëm tek shami i tyre sot, pasi nuk do të arrihi të realizoni synimet tuaja. Bëni kujdes në punë, pasi profesionalizmi juaj do të jetë nën vëzhgim. Në mbetje rekomandohet që dondini në qetësi duke lexuar një libër ose duke menduar.

### VIRGJERESHA

Gjatë kësaj të marie mos hezitoni të ndërmerrni vendime në aspektin profesional. Riheni hekurin sa është i rrezikshëm. Nëse qëllimi juaj kryesor është të fitoni zemrën e dikujt, shprehni lirshëm ndërgjatë. Partneriteti është i papranueshëm në çështje financiare dhe profesionale.

### PESHORJA

Peshoret nuk do të jenë mjaft mirë të orientuar rreth asaj çfarë po ndodh. Ka gjasa që dikush mund të përpiqet t'ju çorientojë. Tregohuni shumë të kujdesshëm si ndaj bisedave ashtu edhe gjatë korrespondencës me dikë.

### AKREPI

Disa Akrepë realisht mund të admirohen. Ndoshta bukuria juaj mund të impresionojë dikë. Do të fitoni vëmendjen e dikujt nga e kaluara. Edhe në aspektin profesional gjithçka do të shkojë ashtu sikurse e dëshironi. E vetmja gjë që mund t'ju shqetësojë, do të jetë shëndeti juaj.

### SHIGJETARI

Duke qenë më optimist dhe duke u treguar më të sjellshëm mund të arrihi një qëllim të caktuar. Megjithatë, mos shpërfilni plotësisht gjithçka që ndodh në fatin tuaj personal ose në karrierë. Fillimisht duhet t'i kushtoni vëmendje problemeve tuaja, më pas mund të ndihmoni dikë.

### BRICJAPI

Disa Bricjapë do të mbërthehen nga një optimizim i tepët. Mund të shpëroni për më të mirën në marrëdhëniet profesionale ose në fatin personal. Por ka gjasa që të jenë thjesht iluzione. Është e rëndësishme të qëndroni me këmbë në tokë.

### UJORI

Ujorët nuk duhet të rrezikojnë këtë të martë. Vegënerisht, kjo vlen për ata që kanë të ardhura financiare të qëndrueshme dhe një marrëdhënie harmonike. Mbrojini këto nga çdo stuhi apo turbulencë.

### PESHQIT

Do të zbuloni detaje të reja në profesionin tuaj, të cilat do të jenë të rëndësishme për ju. Mund të bëni miq të rinj nga një rreth i fuqishëm ose mund të gjeni mbështetje financiare për kreativitetin personal.

**TRAJNERI I KOMBËTARES**

**Në Itali janë të sigurt, Reja ka akord me Dukën**

Armand Duka nuk ka qenë ditën e diel në Itali për t'u takuar (vetëm) me Alberto Zakeronin. Sipas asaj që bëhen me dije "Radio Kiss Kiss" dhe portale të ndryshme sportive në gadishullin Apenin, kreu i FSHP-së ka zhvilluar një takim edhe me Edoardo Rejën, kandidatit e shumëpërfolur si trajnerin e ardhshëm të stolit kuqezi. Sipas asaj që bëhet e ditur



nga "Radio Kiss Kiss", Duka dhe Reja kanë zhvilluar një takim, ku kanë detajuar çdo gjë dhe parimisht kanë arritur akordin, për të cilin tashmë mungon vetëm zyrtarizimi. Reja pritet të vazhdojë me të njëjtat kushte ekonomike si të Kristian Panuçit (250 mijë euro në vit), ndërsa ndihmës i tij mund të jetë Leonardo Koluçi.

**DEDIKIMI**

**Gol për 10 sekonda, Sioni uron Ermir Lenjanin**

Ermir Lenjani u kthye edhe një herë tjetër në protagonist të skuadra e tij në kampionatin zviceran, duke barazuar rekordin për golin më të shpejtë në histori. Pas vetëm 10 sekondash lojë, Lenjani kaloi skuadrën e tij në avantazh përballë Luzernës dhe për këtë ka pasur edhe një urim nga klubi i Sionit. Njëpërmjet një postimi në sajtin zyrtar të klubit, Sioni ka uruar Len-

janin për rekordin, duke i uruar njëkohësisht edhe shumë gola të tjerë në kampionat. "Shënuesi i dy golave të enjten e kaluar në Tun, Ermir Lenjani u rikthye duke zhbllokuar rezultatin pas vetëm 10 sekondash. Shqiptari në të njëjtën kohë shënoi golin më të shpejtë në historinë e Super Ligës. Ai është i barabartë me ish-lojtarin senegalez, Musa Konate, i

cili gjithashtu shënoi pas dhjetë sekondash katër vjet më parë kundër St. Galen (fitorja 3-0). Numri 33 është tani autor i gjashtë golave që nga fillimi i këtij sezoni 2018/2019. Sioni dëshiron të përgëzojë lojtarin në këtë rekord dhe shpresojmë që ta shohim emrin e tij në tabelë shumë herë në javët e ardhshme", shkruhej në urimin e klubit.

Planet e skuadrave të Milanos për sezonin e ardhshëm ndeshen tek emri i trajnerit të Totenhemit

**Interi dhe Milani, derbi për Mauricio Pochetinton**

*Spaleti e Gatzuzo nuk do të qëndrojnë sezonin tjetër*



Jeton Selimi

Ndizet derbi i Milanos, për këtë herë për një trajner. Inter dhe Milani duket se kanë piketuar të dyja argjentinasiin Mauricio Pochetinton, i cili ka kthyer përsëri Totenhemin në majat e futbollit evropian dhe është një nga emrat më të vlerësuar në arenën ndërkombëtare. Argjentinasi njihet mirë nga Gazidis, i cili ua ka sugjeruar drejtuesve të Milanit, pasi e ka parë shpesh nga afër në derbit e Londrës ndaj Arsenalit. Ndërkohë, tek Interi është Javier Zaneti, ai që shtyn për afrimin e ish-futbollistit argjentinasi, me të cilin ka një miqësi që në vitin 1998, kur të dy ishin pjesë e përfaqësueses në



Botërorin e Francës. Por për të afruar Pochetinton nuk do të jetë e lehtë. Pengesa e parë ka të bëjë me rrogën e tij, pasi tekniku kërkon 10 milionë euro në vit, shumë për futbollin italian, ku me përjashtim të Juventusit apo Napolit me sforcime, askush nuk duket në gjendje të garantojë shifra të tilla pa siguruar të ardhura të mëdha nga kualifikimet europiane. Pengesa e dytë ka të bëjë me faktin se ai ka ende një kontratë në fuqi me Totenhemit dhe duhet të jetë

klubi ai që ta largojë, përndryshe kush e dëshiron, duhet të paguajë 40 milionë euro, shifër e cila frenoi edhe Real Madridin në këtë sezon. Ndaj, klubit italian shpresojnë që Pochetino të mbyllë këtë sezon me një dështim, pasi nëse mbetet jashtë Ligës së Kampioneve për edicionin e ardhshëm, të gjithë janë të bindur se rruga e tij me atë të Totenhemit do të ndahet në përfundim të sezonit dhe milanezët do të kenë rrugën e hapur për të kontaktuar argjentinasiin.

**PISTË E RE**

**Roma kërkon Zhoze Murinjon për sezonin e ri**

Zhoze Murinjo është një nga emrat më të lakmuar në botë dhe klubit më të mira duan ta kenë në drejtimin e ekipit të tyre. Së fundmi, portugezi është përfolur për shumë për një kalim në krye të Bajernit të Mynihut apo Paris Sën Zhërmenit, por zhvillimet e fundit nxjerrin në skenë një tjetër pistë. 56-vjeçari është në 'orbitën' e Romës dhe presidenti Xhejm Palota është gati t'i dhurojë portugezit projektin e shumëdëshiruar. Roma nuk është një nga top-klubet europiane, por me Murinjon në stol dhe investimet e duhura do të mund të ngushtonte shumë hendekun me Juventusin në Serinë A dhe me klubit e tjera në Champions League.



**Drejtnesit mendojnë ndryshe**

**Rumenige dhe Hënes, "sherr" për trajnerin Kovaç**

Fitorja 5-0 ndaj Borussia-s së Dortmundit ka qenë një hap i madh i Bajernit të Mynihut në drejtim të titullit kampion. Një sukses që vulos përmbynsjen e madhe të një sezoni të nisur keq, por që po mbyllet në mënyrën e duhur në kampionat. Por pavarësisht kësaj, te Bajerni ende nuk janë të qetë. Sipas asaj që raporton "Bild", ka një kontradiktë të madhe mes dy drejtuesve kryesorë, Karl-Haia Rumeniges dhe Uli Hënesit. Rumenige, shefi ekzekutiv i klubit bavarez, u shpreh ditën e diel se "asnjë nuk e ka vendin e punës të sigurt te Bajerni. Nëse do ta mbash vendin e punës, duhet të performosh në nivele të larta dhe kjo vlen edhe për Kovaç. Çdo njeri këtu duhet të përballojë presionin, në të kundërt është në klubin e gabuar". Fjalë këto që nuk i garantojë vendin kroatit dhe për sezonin e ri, pasi dihet që Rumenige dëshiron një emër big në stolin bavarez. Nga ana tjetër është Uli Hënes, presidenti i Bajern Mynihut, që e mbështet shumë trajnerin Niko Kovaç, pasi ishte pikërisht ai, njeriu që e sponsorizoi kroatin asokohe. "Çdo gjë është në rregull. Nëse jam i pakënaqur, nuk do të thotë se do të shkarkoj trajnerin urgjent, këto gjëra mund të zgjidhen me bisedim", u shpreh Hënes. Sipas "Bild", fundi i sezonit dhe numri i trofeve të fituara do të jenë vendimtare në vazhdimësinë e Kovaç në stolin e Bajernit.

**Gati emri i stadiumit**


**Sportingu do të nderojë Kristiano Ronaldon**

Madhështia e Kristiano Ronaldos po arrin majat, ndonëse tashmë 34 vjeç dhe në sezonet e fundit të karrierës. Sipas asaj që shkruan gazeta sportive portugeze "O Jogo", Sportingu i Lisbonës po mendon që të ndërrojë emrin e stadiumit të saj nga "Jose Alvalades" dhe t'ia kushtojë pikërisht Kristiano Ronaldos. Sportingu i Libonës ëndërron që Ronaldo ta mbyllë karrierën në klubin ku u formua dhe prej ku u nis drejt Mançester Junajtid për të filluar epokën e tij të lavdishme. Drejtuesit e klubit portugez duan që ta bindin "CR7" në këtë aventurë të fundit, duke e titulluar stadiumin dhe duke i lënë dorë të lirë në të drejtat e emrit.





**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Janë ilogari.
6. Kufizojnë një trup.
10. Janë nocionet e para.
13. Janë vendet si Katar.
14. Shkruejnë nga e djathta në të majtë.
16. Një pije... dardhe.
17. Janë me marka në armatura.
19. Artikull spanjoll.
20. Një pjesë e sadistëve.
22. Janë shemra.
25. Mund të jenë informacioni.
27. Fillojnë javën.
28. Janë gratë në Marrakesh.
30. Janë dhoma.
32. Një Ardian guvernator i Bankës.
33. Demek s'ka kufij.
35. Janë centralist si Chernobyl.
38. Mbyllin një dyqan.
40. Një impiant hi-fi.

42. Rolet pa re.
44. Një pjesë e parlamentit.
46. Kufizojnë një send.
47. De Filipi e Amici.
49. Pagëzoi Shën Palin.
52. Ushtrohet një me tryzni.
54. Victorien dramaturg.
55. Eshhtë edhe ai i Zi.
56. Fillojnë tatëpjetën.

**VERTIKAL**

1. Hunt aktore.
2. Nolde piktor.
3. Gysmw siklet.
4. Marsi në Areopag.
5. Janë antena satelitore.
6. Rrihet në fund.
7. Pak tebaizëm.
8. Janë taksat.
9. Një test.
10. Ferrara regjisor.
11. Eshhtë luftë.
12. Kufizojnë citatet.
15. Një lëndë e organizmit.
18. Qureshin edhe Eumenide.

21. Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
23. Eshhtë si baba.
24. Julia i Familja Addmas.
26. Jules shkrintar.
28. Mafia pa zë.
29. Role pa zë.
31. Eshhtë zbulurim në skenë.
33. Inicialet e Morricone-s.
34. Irene aktore.
36. Kufij në Oslo.
37. George shkrintar.
39. U shkrua nga Emile Zola.
41. U shit për një pjatë thjerza.
43. Film shqiptar.
45. Me të nxjerrin trarë.
47. Bega komik.
48. Eshhtë yll i skuadrës.
50. Fillojnë ndeshjen.
51. Satelit i Uranit.
52. Inicialet e Dukas kompozitor.
53. Mbarojnë fare.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

1. Ndan kapitujt
8. Emri i Gonçarov.
12. Eshhtë e hollë dhe therëse.
13. Inicialet e Stone regjisor.
14. Eshhtë edhe ajo mistral.
15. Kryeqyteti i Marokut.
16. Ki Moon në OKB.
18. Eshhtë lloj papagalli.
19. Një pjesë e amerikanëve.
20. Gysmë tandem.
21. Hapet me trapano.
23. Një sigël maunesh.
24. Ishite djali i Odiseut.
26. Eshhtë sherr në shtyp.
27. Artikull spanjoll.
29. Eshhtë zog i verdhë.
30. Mund të jetë kuzhine.
31. Inicialet e Lattuada regjisor.
33. Eshhtë shtet i papës.
35. Mbeten në fund.


**VERTIKAL**

36. Pesci aktor.
38. Unë dhe ti.
39. Jepet për hartim.
41. Kërkohej nga poeti.
43. Rastisin në krye.
44. Eshhtë edhe ai i Kuq.
46. I dha fillin Tezeut.
48. Në krye të armatës.
49. I vetmi në orar.
51. Eshhtë ai që premtom të bëhet as.
52. Leblanc që krijoi Arsene Lupin.




7. Triaç që qe tenist.
9. Tregohet nga busulla.
10. Kaçaturian kompozitor.
11. Fillojnë natën.
16. Vallëzon me tutu.
17. Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
18. Mund të jenë kursimi.
20. Janë katër në violinë.
21. Janë vendet e pazëna.
22. Në mes të Edgar dhe Poe.
24. Janë ato që na përkasin.
25. Këngëtare italiane.
26. Një pjesë e pavjionit.
27. Braktisi Didonën.
28. Mune të jenë lubrifikantë.
32. Lumë në Francë.
34. Kush është... do të pijë.
37. Nolde piktor.
40. Parashetë zvogëluese.
42. Zanore arabe.
43. Rastet pa set.
44. Pak dramatike.
45. Maket pa kufij.
47. Inicialet e Nolte aktor.
48. Inicialet e Moravia-s.
50. Kështu përfundin një polic.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|   |   |   |   | 9 |   | 5 |   |   |
|   |   | 9 |   |   |   | 3 | 8 |   |
|   |   |   |   | 4 | 7 |   | 2 | 6 |
|   |   |   | 6 | 9 | 2 |   |   |   |
| 4 | 5 |   |   |   | 8 |   |   |   |
|   | 6 |   |   |   |   |   |   | 3 |
|   |   | 1 | 5 |   |   |   |   |   |
| 7 |   |   |   |   |   |   |   |   |
|   | 3 |   |   |   |   | 6 | 4 |   |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 9 | 4 | 8 | 7 | 5 | 6 | 3 |
| 3 | 4 | 8 | 5 | 6 | 9 | 1 | 7 | 2 |
| 5 | 6 | 7 | 1 | 2 | 3 | 8 | 9 | 4 |
| 2 | 7 | 3 | 8 | 4 | 5 | 6 | 1 | 9 |
| 4 | 5 | 1 | 3 | 9 | 6 | 2 | 8 | 7 |
| 8 | 9 | 6 | 7 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 3 | 5 | 9 | 7 | 8 | 4 | 2 | 1 |
| 7 | 1 | 2 | 6 | 3 | 4 | 9 | 5 | 8 |
| 9 | 8 | 4 | 2 | 5 | 1 | 7 | 3 | 6 |

*Argëtim filozofik*

- Para se të flisni pyesni veten: Ajo që do të them është e sjellshme, është e nevojshme, është e vërtetë, është më mirë se heshitja?  
 - Në përpjekje për të bërë të tjerët të lumtur, kam harruar veten time !!!  
 - Ka fjalë që lotojnë dhe lot që flasin ...  
 - Shiu bie kur retë nuk mund të mbajnë më peshën. Lotët bien kur zemra nuk mund të mbajnë më dhimbjen.

*Thënie të mençura*

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

|    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | 3  |    | 1  | 6  | 9  | 8  | 11 | 8  | 16 | 4  | 8  |    | G | A | T | I | T | A | L | E | N | T | I |   |   |
| 18 | 5  | 16 | 4  | 12 | 7  | 3  |    |    | 2  |    | 1  | 14 |   | A | R | A | M | P | A | F | T | E | R |   |   |
| 8  | 1  | 6  |    | 3  |    | 11 |    | 8  | 8  |    | 9  | 6  | 1 |   | R | E | T | H | E | P | A | T | I | T |   |
| 3  | R  | 9  | 5  | 2  | 7  | 3  | 12 | 9  | 9  | 13 |    | 12 |   |   | G | S | H | E | R | E | T | I | K | E |   |
| 9  | K  | 5  | 2  | 7  | 3  | 1  | 4  | 8  | 15 | 1  | 4  |    |   |   | A | K | O | M | I | T | E | T | E | M |   |
|    |    | 9  | 6  | 8  | 12 | 8  | 9  | 7  |    | 6  | 10 |    |   |   | M | E | K | I | P | E | T | T | M | A |   |
| 4  | 3  | 5  | 9  | 7  |    | 8  | 3  | 5  | 12 | 8  | 9  | 7  |   |   | E | I | C | N | E | T | K | A | P | A | K |
| 3  |    | 16 | 1  | 6  | 4  |    |    | 7  | 15 | 8  | 4  | 1  |   |   | L | I | S | G | C | S | T | I | L | E |   |
| 8  | 4  | 1  | 6  | 6  | 1  |    |    | 16 | 7  | 7  | 12 | 1  |   |   | L | R | S | W | I | N | G | S | I | T |   |
| 13 |    | 6  | 7  |    |    | 11 | 1  | 7  |    | 4  | 1  | 18 |   |   | A | O | P | A | T | E | N | T | A | T |   |
| 11 | 1  | 7  |    | 17 | 7  | 1  | 12 |    | 6  | 8  | 17 | 1  |   |   | M | A | Y | E | O | R | A | R | I |   |   |
| 10 | 13 | 4  | 13 | 3  | 8  | 16 | 4  | 7  | 4  |    | 1  | 3  |   |   | G | Y | P | I | P | O | L | I | T | I | K |

- Gjithkush ka të drejtë të dashurojë personin e gabuar. Në realitet gabimi është të mos e bëjë.
- Jeta është si Facebook-u. Njerëzit i pëlqejnë problemet tuaja dhe pastaj komentojnë. Por askush nuk do të zgjidhë, sepse të gjithë janë të zënë e me publikimin e problemeve të tyre.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | K | A | M | A | R | S | H | P | R | T |   |
| K | A | O | S | I | M | W | K | U | R | A |   |   |
| S | H | E | N | D | E | T | I | A | N | E | T |   |
| A | T | A | T | E | L | E | F | O | N | A | T |   |
| K | U | V | E | R | T | A | T | R | I | T | E | T |
| N | E | R | V | T | I | S | E | L |   |   |   |   |
| A | R | A | S | M | A | T | R | O | N | A |   |   |
| R | E | V | O | L | T | A | N | E | S | O | N |   |
| K | L | E | E | D | G | D | C | R | T |   |   |   |
| A | L | I | T | A | R | E | M | A | M | I |   |   |
| T | A | K | I | E | M | I | L | V | R | A | K |   |
| A | R | I | K | T | A | P | I | N | V | A |   |   |
| B | E | S | N | I | K | U | A | R | E | S | T |   |
| A | D | M | A | T | E | R | I | A | L | L |   |   |
| T | R | I | M | E | R | I | T | E | D | E |   |   |
| P | A | R | A | K | A | L | I | M | F | A | T |   |
| A | L | I | T | E | R | A | C | I | O | N | I |   |
| T | I | M | E | H | V | L | I | K |   |   |   |   |
| E | E | A | S | T | O | A | T | I | L | A |   |   |
| N | N | T | K | A | L | L | E | P | T |   |   |   |
| T | E | S | A | R | A | J | E | M | I | R | O |   |
| A | E | M | R | T | K | A | P | A | K | E | T |   |
| T | O | T | A | M | A | R | A | A | T | I |   |   |

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

